

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Winter 1-2021

TERRORIZMI DHE E DREJTA NDËRKOMBËTARE

Alma Vuniqi

University for Business and Technology

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Political Science Commons](#)

Recommended Citation

Vuniqi, Alma, "TERRORIZMI DHE E DREJTA NDËRKOMBËTARE" (2021). *Theses and Dissertations*. 2068.
<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/2068>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.



Kolegji UBT
Fakulteti i Shkencave Politike

TERRORIZMI DHE E DREJTA NDËRKOMBËTARE

Shkalla Bachelor

Alma Vuniqi

Janar/2021

Prishtinë



Kolegji UBT
Fakulteti i Shkencave Politike

Punim Diplome
Viti akademik 2017/2018

Alma Vuniqi

TERRORIZMI DHE E DREJTA NDËRKOMBËTARE

Mentori: Dr. Sc. Gjon Culaj

Janar/2021

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Aktet terroriste janë veprime kriminale dhe rrjedhimisht, janë pjesë e tagrit të sistemit të drejtësisë penale. Standardet e të drejtave të njeriut do të zbatohen pavarësisht nëse një incident i caktuar konsiderohet si akt terrorist apo një vepër tjetër që hyn në kategorinë e krimeve të rënda. Terrorizmi konsiston në kryerjen e një krimi nga një individ, një grup apo nga një shtet. Terrorizmi përdoret për të ngjallur te njerëzit një ndjenjë frike e cila në shumë raste është shumë më e madhe se pasojat e vërteta të aktit. Këto akte kane dy shënjestra, popullsinë ose dikasteret e rëndësishme të një shteti. Shkaqet e terrorizmit janë politike, për destabilizimin e një shoqërie por edhe për hakmarrje. Qëllime të ndryshme kanë çuar në themelimin e organizatave të ndryshme të cilat më pas nëpërmjet mesazheve të tyre me karakter politik ose fetar ngjallin frikë dhe panik në radhët e popullsisë. Shumë ide politike janë instrumentalizuar nga organizata terroriste për të justifikuar veprimet e tyre. Si rrjedhojë grupe terroriste eksitojnë në çdo ideologji.

Fjalët kyqe: akte terroriste, terrorizem, krim, grupe terroriste.

MIRËNJOHJE DHE FALENDERIME

U falënderohem dhe u jam mirënjohëse gjatë gjithë jetës familjes time, shoqërisë, e gjithë profesorëve që më ndihmuan e më qëndruan afër gjatë gjithë kësaj kohe. Pa përkrahjen e juaj për mua arsimimi do ishte shumë më vështirë. Studimet e larta universitare nuk ishin aspak të lehta mirëpo unë me ndihmën e juaj ja dola.

E falënderoj për zemërsisht mentorin e temës Prof. Gjon Culaj, për përkrahjen dhe mbështetjen e pandalshme që ma ofroi gjatë gjithë kësaj kohe, dhe po ashtu për finalizimin e punimit të diplomës.

Prishtinë, 2021

PËRMBAJTJA

FJALORI I TERMAVE	IV
1. HYRJE	1
2. SHQYRTIMI I LITERATURËS	3
2.1. Vështrime të përgjithshme lidhur me terrorizmin	3
2.1.1. Vështrim historik mbi terrorizmin	3
2.1.2. Nocioni i terrorizmit	6
2.2. Terrorizmi dhe e drejta ndërkombëtare	10
2.2.1. Konventa Për Parandalimin e Terrorizmit e Këshillit të Evropës.....	10
2.2.2. Konventa kundër mbajtjes së pengjeve e miratuar nga OKB.....	15
2.2.3. Konventa për parandalimin dhe luftën ndaj krimeve kundër personave ndërkombëtarisht të mbrojtur, përfshirë agjentët diplomatik	16
2.2.4. Konventa për shtypjen e atentateve terroriste të kryera me dinamit dhe Konventa për shtypjen e financimit të terrorizmit: definimi i terrorizmit ndërkombetar në këto konventa.	18
2.2.5. Konventa për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e të ardhurave të krimit dhe financimin e terrorizmit	20
2.3. Luftimi i terrorizmit	22
2.3.1. Masat për parandalimin e terrorizmit	22
2.3.2. Masat për zbulimin e kryerësve të akteve terroriste	25
2.3.3. Politikat ndëshkimore dhe luftimi i terrorizmit	26
2.3.4. Format e luftimit të krimit të organizuar	27
2.3.5. Mekanizmi institucional në Republikën e Kosovës në luftën kundër terrorizmit	30
3. DEKLARIMI I PROBLEMIT	36
4. METODOLOGJIA	37
5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	38
6. REFERENCAT	40

FJALORI I TERMAVE

OKB- Organizata e Kombeve të Bashkuara

BE- Bashkimi Evropian

OSBE- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

KS- Këshilli i Sigurimit

..

1. HYRJJE

Terrorizmi vazhdon të mbetet një nga kërcënimet kryesore të sigurisë, si në nivel vendi po ashtu edhe në nivel ndërkombëtar, duke kërcënuar jo vetëm jetën dhe pronën, por edhe vlerat demokratike dhe vet mënyrën e jetesës së shoqërisë. Trendi global i terrorizmit dhe shtrirja e tij, sidomos gjatë dy dekadave të fundit, ka kërcënuar edhe Republikën e Kosovës, si dhe gjithë rajonin, Evropën dhe më gjerë.

Gjatë të gjitha kohëve të kaluara historike janë evidentuar sulme të ndryshme terroriste, të cilat ndër vite për shkak të formave dhe përmasave të reja, që manifestohen në çdo aksion terrorist, ndikojnë, jo vetëm në çorganizimin e jetës politike të një shteti, por edhe në shkaktimin e krizave dhe konflikteve të ndryshme ndërshtetërore me pasoja të gjera ndërkombëtare. Shkalla e lartë e rrezikshmërisë, e shoqëruar me elementin tejet dinamik të ndërkombëtarizimit, kanë bërë që fenomeni terrorist, në asnjë variant të manifestimit të vet, tashmë të mos kuptohej ose trajtohej vetëm si problem nacional, por si proces i filluar ndërkombëtar, gjegjësisht si dukuri kriminale ndërkombëtare, e cila nuk respekton rregulla të veprimit dhe kufij politikë.

Kjo mund të kuptohet edhe nga fakti se mjetet moderne të komunikimit dhe lidhjeve, me anën e të cilave, qytetarët brenda disa orëve mund të lëvizin nga njëra pjesë në pjesën tjetër të botës, u mundësojnë edhe grupeve të ndryshme terroriste lëvizje maksimale dhe propagandë optimale gjatë kryerjes së veprave të tyre gjakatare. Këtu, pra, kemi të bëjmë me një fenomen unikat kriminal, në të cilin vendi i veprimit dhe ai i pasojës mund të jenë mijëra kilometra larg njëri-tjetrit.

Numri gjithnjë e më i madh i grupeve terroriste, qëllimi dhe karakteri i tyre i komplikuar politik, viktimat e shumta, si dhe kuptimet e ndryshme të nocionit terrorist, e parashtrajnë kërkesën imperative për përkufizimin ekzakt të kuptimit të terrorizmit në përgjithësi, dhe të atij ndërkombëtar, në veçanti. Pra, duhet flakur praktikën e deritashme, kur i njëjti person, në të njëjtën kohë dhe për të njëjtën vepër në një të bashkësi shoqërore, është trajtuar dhe gjykuar si kriminel, ndërsa në tjetrën është respektuar si hero dhe patriot. Një përkufizim universal i kuptimit të terrorizmit, pa dyshim që do të kishte ndikuar në gjykimin unik dhe luftimin efikas të këtij fenomeni kriminal ndërkombëtar.

Terrorizmi bashkëkohor, si një nga format e dhunës, është bërë brengë tejet e rëndësishme për shtetin dhe organet e tij të mbrojtjes, si dhe për Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Aktiviteti terrorist në shekullin e kaluar ka qenë problem i madh për sistemin ndërkombëtar të sigurisë dhe vazhdon të përhapë frikë, panik dhe pasiguri në tërë botën. Në përkufizimin e nocionit të terrorizmit vihet në dukje dhuna si treguesi më markantë i terrorizmit bashkëkohor. Metoda e terrorizmit është dhuna, caku i tyre janë qeveritë dhe qytetarët, shkaktimi i frikës dhe ndryshimi i dhunshëm politikë e social si qëllime kurse numri i madh i viktimave, në mënyrë të tmerrshme ndikojnë në shkaktimin e frikës.

2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Ky hulumtim është ndarë në disa pjesë që të na ndihmojë ta kuptojmë punimin. Gjithashtu, kemi përdorur një numër të ndryshëm të literaturës, e cila na ka ndihmuar ta kuptojmë terrorizmin në mënyrë më të qartë dhe të kuptueshme. Po ashtu, kemi konsultuar edhe literaturë të ndryshme rreth kësaj teme nga gjuha shqipe dhe gjuha angleze.

2.1. Vështrime të përgjithshme lidhur me terrorizmin

2.1.1. Vështrim historik mbi terrorizmin

Shtetet e ndryshme kanë dëshmuar lloje të shumta aktesh terroriste. Në Angli që në vitin 1891 u shfaq lëvizja terroriste irlandeze me qëllim pavarësinë nga Britania. Kjo lëvizje ka vazhduar derisa në vitin 1920 arriti t'i merrte disa lëshime thelbësore nga qeveria britanike. Kjo nuk e ndaloi vazhdimësinë e operacioneve terroriste të kryera nga organizatat irlandeze, të cilat akoma operojnë deri më tani, duke zënë një vend të dukshëm mes lëvizjeve kombëtare në ndarjen e aktivitetit terrorist dhe klasifikimin e tij (*Tim Pat Coogan, The IRA, Palgrave, New York, 2002*).

Periudha e zbatimit të dhunës nga anarkistët spanjoll, ka filluar në vitin 1878, pra në kohën e njëjtë kur kishte filluar edhe në Rusi dhe në Itali me atentatin e pasuksesshëm ndaj mbretit Alfonso XII. (*Demolli, Terrorizmi, Prishtinë, 2002, fq. 40*). Terrorizmi u shfaq edhe në Indi dhe Japoni. Dy kryeministra janë vrarë në Tokio e të mos përmendim shumë ministra tjerë të qeverisë – kah fundi i shekullit XIX dhe një tjetër më 1932. Madje, ka qenë edhe një tentim për vrasjen e perandorit. Në Indi, vrasësit politikë u shpeshuan gjatë dekadës para Luftës së Parë Botërore. Por, nënbreiti, lordi Majo, është vrarë më herët, më 1872 (*Demolli, Terrorizmi, Prishtinë, 2002, fq. 40*).

Në fund të Luftës së Dytë Botërore aktet terroriste u zhvendosën nga Evropa në Lindjen e Mesme dhe në Azi. Nuk kishte terrorizëm neonazist apo neofashist pas vitit 1945, ashtu siç frikoheshin shumica. Me rënien e forcave të Boshtit Qendror, entuziazmi fanatik është tretur. Në Evropën Lindore dhe në Ballkan, përfshirë edhe rajonet ku terrorizmi ishte tipik, prania e

Armatës së Kuqe dhe, më vonë, dora e fortë e policisë lokale sekrete, ishte e mjaftueshme për të vepruar si siguruese. Madje edhe në Spanjë, një nga vendndodhjet klasike të terrorizmit, as anarkistët apo seperatistët baskë, nuk guxonin ta sfidonin diktatorshipin ushtarak. Anarkizmi spanjoll nuk ishte më forcë vitale dhe baskët duhej të prisnin për një liri relative, pas vdekjes së Frankos (Franco), për të vazhduar aktivitetet e tyre (<https://telegrafi.com/historia-e-terrorizmit-hovi-keq-shekulli-xix-dhe-shekullit-xx/>).

Në shoqëritë kryesisht agrare, kjo mori formën e luftës guerile, me Kinën dhe Indokinën si shembuj klasikë. Në shoqëritë urbane, si Palestina dhe Qipro, aktiviteti, domosdoshmërisht, zuri vend kryesisht në qytete. Në Algjeri lufta kundër Francës vazhdoi në qytete dhe në fshatra dhe elementet e terrorizmit dhe të luftës guerile u shfaqën krah për krah.

Përpara mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, në Europë kishte filluar të manifestohej ajo që më vonë u quajt “*terrorizëm i financiar nga shteti*”. Kështu, shumë zyrtarë në Qeverinë dhe ushtrinë serbe ishin përfshirë në mbështetjen, trajnimin dhe pajisjen me armë të grupeve të shumta në Ballkan, të cilat ishin aktive në vrasjen e Archduke Franz Ferdinand më 1914 në Sarajevë. Në vitet 1930 u pa një valë e re vrasjesh politike, meritat e të cilave i korrespondojnë fjalës terrorizëm. Kjo çoi në shfaqjen e propozimeve të disa shteteve në hartimin e konventave, për të parandaluar dhe dënuar terrorizmin, si dhe krijimin e një gjykate ndërkombëtare penale. Pavarësisht kësaj, gjatë kohës midis dy luftërave terrorizmi i referohej masave të ashpra që imponoheshin nga regjimet e ndryshme totalitare si nazizmi në Gjermani, fashizmi në Itali dhe stalinizmi në Rusi. Disa analistë si Bruce Hoffman theksonin se “*përdorime të tilla janë quajtur përgjithësisht “terror” me qëllim për të dalluar atë dukuri nga “terrorizmi”, i cili kuptohej të ishte dhuna e kryer nga njësi joshtetërore. Megjithatë jo të gjithë bien dakord se terrorizmi duhet të konsiderohet si një ndërveprim joqeveritar.*

Midis 1960-ës dhe 1970-ës, numri i atyre grupeve që mund të përshkruheshin si terroriste përfshinte jo vetëm nacionalistët, por ata të motivuar nga konsiderata etnike dhe ideologjike. Kështu u krijuan grupe të tilla si Organizata Palestineze, Basque ETA, Ushtria Provizore e Republikës Irlandeze, Brigadat e Kuqe Italiane etj.

Terrorizmi në Palestinë, i përhapur nga “Irgun”, u shfaq fillimisht në fillim të Luftës së Dytë Botërore, por pastaj “Irgun” kërkoi armëpushim dhe disa nga anëtarët e saj iu bashkuan forcave britanike. Sidoqoftë, edhe para përfundimit të luftës, grupet përtëritën sulmet e tyre

kundër pushtetit të mandatuar. Një degë më radikale, banda “Stern” (“Luftëtarët për lirinë e Izraelit”), kanë sulmuar vazhdimisht dhe lideri i tyre është kapur dhe ekzekutuar nga policia britanike në Tel-Aviv më 1942. Politika e bandës “Stern” ishte mjaft konfuze; në fazën fillestare të luftës ata kërkonin kooperim nga italianët, madje edhe nga gjermanët dhe më vonë ata janë tërhequr nga komunistët sovjetikë. Manifestet e tyre kundër imperialiste duket sikur të ishin të shkruara në Moskë. Por, motivimi i tyre majtist nuk ishte i rënjosur thellë (*Sulejmani, Dukuria e terrorizmit, -studim krahasues juridik penal, 2014, fq. 45*).

Shumë qeveri nuk kanë arritur të vlerësojnë gjerësinë dhe ndërlikimet e kërcënimit terrorist ndaj shoqërive të sotme. Si rrjedhim, një numër i madh vendesh, përfshirë disa demokraci perëndimore, nuk i janë përkushtuar seriozisht punës për ta përballuar me efektshmëri këtë sfidë (*Marevci, Luftimi i terrorizmit bashkëkohor, Ferizaj, fq. 28*). Një nga arsyet madhore për këtë mosarritje është pështjellimi përkufizues e moral rreth faktit se ç’është në vetëvete terrorizmi (*Marevci, Luftimi i terrorizmit bashkëkohor, Ferizaj, 2014, fq. 28*).

Terrorizmi e mori kuptimin negativ që mbart sot edhe nga shkrimet e disa politologëve si anglezi Edmund Burke, filozof politik, i cili e popullarizoi termin terrorist në anglisht, duke dënuar revolucionarët francezë. Shfaqja e ideologjisë politike si ajo e marksizmit, gjithashtu, krijoi një sens produktiv të paqëndrueshmërisë së rregullit ekzistues, duke e përcaktuar terrorizmin si një mjet për ndryshim. Revolucionari Italian Carlo Pisane, i cili e njihte përdorimin e terrorizmit, për të shpërndarë një mesazh audiencës ndryshe nga ai i përcaktuar dhe të tërhiqte vëmendjen te një qëllim – duke e përcaktuar këtë si një formë të re të terrorizmit.

Teza e Pisane-s, e cila nuk ishte e re, por njihej edhe nga Zealots-Sicari dhe Assasin-sit, – u vendos fillimisht në praktikë nga Narodnaya Volya, një grup popullor rus i krijuar më 1878 për të kundërshtuar regjimin Carist. Ngjarja më e madhe e grupit ishte vrasja e Aleksandrit II më 1881, njëkohësisht edhe përmbysja e regjimit carist. Grupe nacionaliste si ato në Irlandë ose në Ballkan e adoptuan terrorizmin si një mjet për të arritur dëshirat dhe qëllimet e tyre përfundimtare.

Aktualisht fenomeni i terrorizmit si një nga kërcënimet më serioze globale, është bërë objekt studimor jo vetëm i studiuesve të njohur në të gjitha shkollat dhe universitetet e botës, por edhe analistëve e specialistëve në agjenci të intiligjencës, sigurisë ligjberëse dhe zbatuese.

2.1.2. Nocioni i terrorizmit

Terrorizmi si nocion përkufizohet e interpretohet në mënyra të ndryshme. Vetë fjala “terrorizëm” paraqet një sintezë të emrit latin terror dhe sufiksit po latin, por me prejardhje greke, “izm”. Fjala terror, rrënjët e veta i ka në foljen “tras”, e cila do të thotë dridhje. Haset në fjalët greke “ipee”, në atë perse “tersidan”, latine “ters” apo “tres”, pellazge “terr”, që nënkupton errësirën e thellë e të plotë, botën pa dritë, por edhe tmerrin, trishtimin, shkaktimin e frikës dhe të dridhjes, dhunën politike, deri te shkatërrimi fizik i kundërshtarit (*Latifi, Elezi, Hysi, Politika e luftimit të kriminalitetit, Prishtinë, 2012, fq. 141-143*).

Autorë të ndryshëm janë përpjekur ta shpjegojnë dukurinë e terrorizmit. Kështu, Paul R. Pillar thekson “*Terrorizmi (Pillar “Terrorism and U.S Foreign Policy”, Brookings Institute Press: Washington DC, 2001) është një sfidë e cila duhet të menaxhohet dhe jo të zgjidhet*”. Të tjera të dhëna flasin edhe për forma të terrorizmit të shfaqura gjatë periudhës së Revolucionit Francez. Termi terrorizëm vjen nga shprehja “*regime de la terreur*”, frëngjisht, regjimi i terrorit. që zotëroi në Francë në vitet 1793-1794. Fillimisht terrori ishte instrument i shtetit dhe përdorej për të konsoliduar fuqinë e regjimit revolucionar të Qeverisë. Terrori përdorej për të mbrojtur Qeverinë nga të gjithë elementet që konsideroheshin diversioniste dhe kërkonin përmbyshjen e saj. Pra, fillimisht gjatë kësaj kohe të regjimit në Francë, terrorizmi përdorej në kuptimin e tij pozitiv. Udhëheqësi i Revolucionit Francez Maximillien Robespierre e shihte terrorizmin si vital për mbrojtjen e Qeverisë së sapokrijuar, duke shpallur më 1794 që “*Terrori nuk është gjë tjetër veç drejtësi, manifestim i virtytit, mjet në funksion të parimit të përgjithshëm të demokracisë, i zbatuar në vendin tonë për nevojat më urgjente.*” (*Maksimillien Robespierre, “Justification of the use of Terror”, libri i Historisë Moderne.*)

Kuptimet historike terrori dhe terrorizmi janë nocione, kuptimi i plotë i të cilave në literaturë shkencore ende nuk është sqaruar. Shikuar historikisht, fjala “*terreur*”, frikë, panik. (*International Terrorism” [Deklarata për masat në lidhje me eliminimin e terrorizmit ndërkombëtar], Dokumenti A/RES/49/60, 1994, para. 1; dhe rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1373 (2001), para. 3, dhe 1566 (2004), para. 3*). Që nga ajo kohë e deri në ditët e sotme, fjala “*terror*”, shërben si sinonim i gjendjes shpirtërore të frikës individuale, si pasojë e presionit të caktuar politik, si dhe për shpjegimin e pozicionit kolektiv përballë një rreziku të caktuar (*terreur panique*).

Tradicionalisht me fjalën “terror”, është kuptuar zbatimi i dhunës politike me qëllim të mbrojtjes së interesave shtetërore gjatë fazave të ndryshme revolucionare të karakterizuara me kërcënime dhe zbatime të ndryshme të dhunës politike. Këtu terrori, si dhunë e instrumentalizuar, zakonisht propagandohet në mënyrë të stilizuar, si mjet i domosdoshëm për mënjanimin e konflikteve të ndryshme politike, rivendosjen e rendit, qetësisë publike ose harmonisë shoqërore (*International and Regional Legal Instruments Related to Terrorism and Cooperation in Criminal Matters* [Statusi në zonën e OSBE-së i konventave dhe protokolleve universale antiterrorizëm, si edhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare dhe rajonale që lidhen me terrorizmin dhe bashkëpunimin në çështjet penale], OSBE, shtator 2013).

Ndërkaq, me fjalën “terrorizëm”, kuptohen veprat e ndryshme penale të drejtuara kundër shtetit, të kryera nga individët ose grupet e ndryshme të personave në shtetin e vet ose në shtetin e huaj, me qëllim të ndikimit në realizimin e qëllimit të caktuar politik (Rezoluta nr. 1566 (2004) miratuar nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së, në takimin e vet nr. 5053, më 8 tetor 2004 (S/RES/1566 (2004), . Kjo rezolutë nuk është ligjërish e detyrueshme).

Për më tepër, një përkufizim më i gjerë nga ç’ duhet i terrorizmit mund të shpërdorohet për të shtypur kundërshtimet paqësore dhe minimin e shoqërisë demokratike. Ndaj edhe përcaktimi i një përkufizimi të saktë mbi terrorizmin përbën një element me shumë rëndësi në luftën me sukses kundër terrorizmit, duke garantuar përputhshmëri me sundimin e shtetit ligjor dhe me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Kjo nuk ka të bëjë thjesht dhe vetëm me konotacionin politiko moral të termit. Aplikimi i termit mbart gjithashtu implikime të rëndësishme, qoftë në kuadrin kombëtar, qoftë në arenën ndërkombëtare, për sa i takon p.sh., këndvështrimin ligjor për shkëmbimin e informacionit, garantimin e asistencës reciproke juridike, ngrirjes dhe konfiskimit të asetëve dhe ekstradimit (*Alex P. Schmid, Political Terrorism: A Research Guide to Concepts, Theories, Data Bases and Literature, Amsterdam 1983, fq. 70-111*).

Konkretisht, me fjalën “terrorizëm” kuptohet kërcënimi ose përdorimi i dhunës fizike kundër personave ose kundër pasurisë së tyre, të kryera nga individët ose grupe të ndryshme terroriste me qëllim të arritjes së efekteve të dëshiruara politike (*Krasniqi, Terrorizmi ndërkombëtar, Prishtinë, 2010, fq. 28*).

2.1.3. Karakteristikat dhe elementet kryesore të akteve terroriste

Aktet terroriste në mjaftë vende të botës janë bërë tepër shqetësuese. Numri i tyre ka shkuar duke u rritur vazhdimisht dhe pasojat e këtyre akteve kanë qenë tepër të rënda: viktima të shumta njerëzish, dëme materiale dhe gjendje pasigurie e panik në masë. Aktet terroriste paraqesin rrezik të madh në çdo shoqëri, prandaj angazhimi në luftën kundër tyre është i domosdoshëm, si kundër terrorizmit shtetëror dhe atij të bandave apo organizatave kriminale ashtu edhe terrorit individual. Bashkëpunimi ndërkombëtar në këtë luftë, në bazë të konventave ndërkombëtare dhe të legjislacioneve penale të vendeve të ndryshme, është domosdoshmëri e kohës (*Latifi, Mediat dhe terrorizmi, Revista Juridica, Prishtinë, 2010, fq. 9*).

Terrorizmi arrin në shtëpitë tona nëpërmjet ekraneve televizive, duke na bombarduar nga gazetatat, revistat, ndonjëherë hynë në jetën tona edhe në mënyra të drejtpërdrejta (*White, 2004., Terrorism (përkthim nga anglishtja, Beograd, 2004, fq. 350)*). Akti terrorist mund të konsiderohet edhe: prodhimin, posedimin, marrjen, transportin, furnizimin, shfrytëzimin ose aftësimin për përdorimin e armëve, eksplozionit të armëve nukleare, biologjike dhe kimike ose materieve radioaktive, si dhe hulumtimi e zhvillimi i armëve kimike dhe biologjike ose materieve radioaktive. Pra, veprimin e veprës penale të terrorizmit e përbëjnë:

- Prodhimi,
- Posedimi,
- Fitimi – marrja,
- Transporti,
- Furnizimi,
- Disa nga këto veprime, sipas natyrës së tyre, paraqesin veprime përgatitore ose veprime ndihmëse të disa nga format tjera të aktit terrorist.
- Terroristët e suksesshëm e zgjedhin teknologjinë e vet ashtu që e shfrytëzojnë deri në maksimum mundësinë e dëmtimit të shoqërisë së caktuar (*Latifi, Mediat dhe terrorizmi, Revista Juridica, cituar, 2010, fq. 9*).
- Armë për shkatërrimin në masë “terrorizmi teknologjik”. Ky terrorizëm nënkupton përdorimin e armëve për shkatërrime masive, ose sulme terroriste në sisteme teknologjike, me të cilat dëshirohet të shkaktohet kaos i përgjithshëm. Terroristët mund të përdorin armët për shkatërrim në masë, ose mund të shfrytëzojnë vagonin plotë me kemikalje si bombë kimike, ose të programojnë bombën virtuale nëpërmjet rrjetit

kompjuterik. Terroristë tejet të arsimuar mund të kryejnë të gjitha këto vetëm me një sulm të koordinuar.

- Përcaktimi ligjor i veprës penale të terrorizmit: Kush kryen akt terrorist me qëllim të frikësimit serioz të qytetarëve ose detyrim të organeve të pushtetit...të shtetit tjetër dhe organizatës ndërkombëtare, që të veprojnë ose mosveprojnë, ose me qëllim të destabilizimit serioz ose shkatërrimit të strukturave themelore politike, kushtetuese, ekonomike ose shoqërore... të shtetit tjetër ose organizatës ndërkombëtare... dënohet me burgim në kohëzgjatje së paku 3 vjet...10...vjet,
- frikësimit serioz,
- detyrim të organeve të pushtetit,
- dhe organizatës ndërkombëtare,
- veprojnë ose mosveprojnë,
- destabilizimit serioz ose shkatërrimit të strukturave themelore politike, kushtetuese, ekonomike ose shoqërore (Po aty, fq. 10).

Karakteristikat dhe elementet kryesore të terrorizmit janë:

- Përdorimi i dhunës apo kanosjes sistematike të organizuar;
- Ushtrimi i dhunës nga grupe të caktuara politike;
- Shkaktimi i ndjenjës së frikës, pasigurisë dhe mosbesimit në pushtet të masave të gjëra;
- Asgjësimi i njerëzve dhe të mirave materiale në përmasa të mëdha;
- Nxjerrja e koncesioneve të caktuara politike;
- Fitimi i pushtetit shtetëror mbi terrorin e caktuar;
- Publiciteti dhe tërheqja e vëmendjes së opinionit ndërkombëtar.

Terrorizmi është metodë e cili mund të përdoret për llojet e pakufizuara të qëllimeve. Terrorizmi është metodë inhereente dhe e pashmangshme e luftës që involvon dhunën indiskriminative dhe të lirë mbi viktimat. Terroristët shpesh pohojnë se aksionet, si sulm me bomba, pengmarrja dhe vrasjet janë forma e vetme që kanë në dispozicion për ta larguar regjimin autoritar, tiranik ose represiv (*Latifi, Kriminalistika- Zbulimi dhe të provuarit e krimet, Prishtinë, 2011, fq. 329*). Me këtë rast duhet theksuar një nga format e terrorizmit, që sqarohet nga disa studiues, si Hikmet Yuxheoglu, i cili shkruan se sulmet vetëvrasëse kryhen në dy mënyra: (*Xhanan, Gynesh, Oksyz, Jyxheoglu; Një vështrim Islam mbi terrorin dhe sulmet vetëvrasëse, Tiranë, 2006, fq. 86-87*).

Ekzistojnë sulme vetëvrasëse të cilat kryhen sistematikisht dhe pa u lëkundur nga persona të përcaktuar nga ushtritë e dy vendeve rivale të cilat janë duke luftuar kundër njëra-tjetrës. Këto lloje sulmesh mund të ndahen në dy nëngrupe:

- Sulmi nga një person apo grup i cili kryhet mbi një grup të madh armiqsh ose mbi kazernat e tyre me anë të mjeteve luftarake si p.sh., me aeroplanë, tanke, granate dore, etj. Shembujt nga historia Islame tregojnë se me akte të tilla personat që i kryejnë ato nëse vdesin konsiderohen shehidë. Por ekziston gjithmonë mundësia që ata (sulumuesit) të shpëtojnë gjallë nga këto sulme.
- Një person apo një grup njerëzish vendosin bomba në trupin e tyre ose e lidhin makinën që janë duke drejtuar me një bombë dhe pastaj futen mes ushtarëve armiq ose në mes të fortesave armike duke shpërthyer bombën. Ky lloj sulmi mund të lejohet vetëm në rrethana shumë të kufizuara të cilat përcaktohen vetëm nga juristët Islamë dhe që janë të konceptueshme vetëm gjatë një lufte aktive. Jashtë këtyre rrethanave, sulme të tilla mund të sjellin vetëm mosmarrëveshje. Ato janë veprime të neveritshme të cilat duhet të dënohen. Disa sulme kryhen në vende të cilat nuk janë fare në luftë, vende të cilat i lejojnë këta njerëz të hyjnë aty me apo pa vizë, vende të cilat i lejojnë qytetarët të vendeve të tjera të tubojnë, të edukohen, të banojnë, të hapin biznese, të martohen dhe nëse plotësohen disa kushte i lejojnë madje të bëhen edhe shtetas të atyre vendeve. Në këtë rast, vendi ndaj të cilit kryhet sulmi i ka marrë në mbrojtje duke i hapur të dy krahët për t'i pritur dhe për t'i mbrojtur këta njerëz. Dhunimi dhe shkelja ndaj mikpritjes së treguar do të thotë tradhti dhe kundërvënie ndaj ligjit të lëvizjes së lirë – kjo nuk është e lejueshme.

Këto sulme të drejtuara ndaj të huajve ose qytetarëve të një vendi tjetër me të cilin agresori mund të jetë në luftë; ose në raste kur vendi i tij është i pushtuar; nuk mund as të mirëkuptohen as të lejohen. Krimineli nuk mund të quhet dëshmor.

2.2. Terrorizmi dhe e drejta ndërkombëtare

2.2.1. Konventa Për Parandalimin e Terrorizmit e Këshillit të Evropës

Konventa për Parandalimin e Terrorizmit përbën një bazë solide dhe një instrument shumë të rëndësishëm ligjor, e cila po të ratifikohej nga vendi ynë, do të sillte si nevojë rishikimin e legjislacionit të brendshëm penal material e procedural me qëllim përmirësimin dhe plotësimin e

këtij legjislacioni, si dhe përshtatjen e tij në përputhje me detyrimet e kërkuara nga Konventa. Në studimin tonë iu referuam shteteve të Italisë, Spanjës, Anglisë dhe Portugalisë, të cilat e kanë nënshkruar Konventën, dhe Francës (Franca e ka nënshkruar Konventën më 22.05.2006), duke bërë krahasimin e detyrimeve të saj, me parashikimet që bëhen në legjislacionet e brendshme të këtyre shteteve.

Qëllimi i hartimit të kësaj Konvente është zgjerimi i përpjekjeve të të gjitha shteteve palë, në parandalimin e terrorizmit dhe efekteve të tij, duke përcaktuar masa, që duhet të merren në nivel kombëtar dhe nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar, duke pasur parasysh, zbatimin e marrëveshjeve ose traktateve dypalëshe ose shumëpalëshe, midis palëve (*Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin e Terrorizmit, Varshavë, 2005, neni 2*).

Konventa i referohet politikave kombëtare të parandalimit dhe veçanërisht përfshin katër aspekte që lidhen me parandalimin: trajnimi, edukimi, kultura, media dhe ndërgjegjësimin i publikut; bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve shtetërore; promovimi i tolerancës; bashkëpunimi i qytetarëve me autoritetet shtetërore (*Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin e Terrorizmit, Varshavë, neni 3*). Konventa parashikon bashkëpunimin ndërkombëtar, që synon zgjerimin e kapaciteteve të shteteve palë, në përpjekjet për parandalimin e terrorizmit. Konventa u bën thirrje shteteve palë të asistojnë dhe mbështesin njëri-tjetrin, duke përfshirë shkëmbimin e informacionit, trajnime dhe përpjekje të përbashkëta si skuadra të përbashkëta për analiza dhe investigime në luftë kundër terrorizmit (Po aty, neni 4). Shprehimisht në këtë Konventë kërkohet nga shtetet palë të saj, që të përjashtohen masa ligjore në legjislacionin e brendshëm, duke parashikuar figura të reja të veprave penale, sidomos ato vepra penale të cilat parashikohen edhe nga dispozitat e Konventës, sidomos të neneve 5, 6, 7 të saj.

Po ashtu, Konventa parashikon shprehimisht si vepër penale provokimin publik për kryerjen e një akti terrorist në bazë të të cilit: Provokim publik për kryerjen e një akti terrorist do të thotë shpërndarja e mesazheve publikut ose bërja e ditur e këtyre mesazheve me qëllim nxitjen e kryerjes së një akti terrorist. Në bazë të kësaj dispozite nuk kërkohet që të ketë ardhur pasoja kriminale, domethënë kryerja e aktit terrorist, por nga ana objektive do të mjaftonin veprimet kriminale të shpërndarjes së mesazheve publikut me qëllim për të provokuar kryerjen e një akti terrorist (*Po aty, neni 5, parag. 1*). Konventa përcakton detyrimin që çdo shtet të parashikojë në

legjislacionin e brendshëm penal si figure të re krimi, veprën penale të provokimit publik për kryerjen e një akti terrorist (*Po aty, neni 5, parag. 2.*).

Konventa parashikon si vepër penale rekrutimin për qëllime terroriste në bazë të të cilit: rekrutimi për qëllime terrorizmi do të thotë që t'i kërkohet një personi tjetër që të marrë pjesë ose t'i bashkohet një grupi me qëllim për të marrë pjesë në kryerjen e një ose më shumë akteve terroriste (*Po aty, neni 6, parag. 1.*). Në Konventë, përsëri kërkohet që shtetet palë të saj të përshtatin masa të tilla në legjislacionin e brendshëm penal, në mënyrë që kjo figurë krimi të parashikohet si vepër penale (*Po aty, neni 6, parag. 2.*).

Konventa parashikon një figurë të re krimi, pikërisht atë të trajnimit për qëllime terroriste. Trajnimi për qëllime terroriste do të thotë dhënia e instruksioneve lidhur me përdorimin e eksplozivëve, armëve të zjarrit, armëve të tjera, ose dhënia e instruksioneve për përdorimin e substancave të rrezikshme, metodave të posaçme ose teknikave të tjera, me qëllim përdorimin e tyre për kryerjen e akteve terroriste (*Po aty, neni 7, parag. 1.*). Konventa kërkon, që nga shtetet palë të saj të parashikohet në legjislacionin e brendshëm kjo figurë krimi si vepër penale (*Po aty, neni 7, parag. 1.*).

Po të vihen re mirë nga dispozitat e lartëcekurta, në to del mjaft qartë si element i anës subjektive të veprës penale qëllimi i ndërmarrjes së veprimeve kriminale të lartpërmendura për kryerjen e akteve terroriste. Duke vëzhguar në legjislacionin e brendshëm penal e konkretisht në Ligji Penal të Republikës së Kosovës, që parashikon Aktet Terroriste, përveç parashikimeve të shumë veprimeve kriminale si vepra penale, veprat penale të mësipërme nuk parashikohen në dispozitat e Kodit Penal. Mendojmë që nenet 5, 6, 7 të Konventës për Parandalimin e Terrorizmit e konkretisht: - Provokimi publik për kryerjen e akteve terroriste, rekrutimi për qëllime terroriste si edhe - trajnimi për qëllime terrorizmi të përshtateshin për t'u futur si figura të reja të veprave penale në Kodin Penal. Në këtë mënyrë me këto dispozita të reja penale, do të plotësohej më mirë Ligji Penal që trajton aktet terroriste, duke patur një kuadër më të plotë të dispozitave penale në këtë fushë.

Konventa përcakton që shtetet palë të Konventës të marrin masa në legjislacionin e brendshëm që të parashikohen si veprime kriminale të dënueshme edhe format e bashkëpunimit, të veprave penale të mësipërme e konkretisht, pjesëmarrjen e një personi si bashkëpunëtor për

kryerjen e veprave të mësipërme, organizimin ose drejtimin e personave të tjerë me qëllim për të kryer veprat penale të mësipërme, dhënien e ndihmës për kryerjen e këtyre veprave e bërë me qëllimin për të vazhduar veprimtarinë kriminale të mëtejshme, si dhe e bërë duke e ditur se personat e mësipërm kanë dijeni dhe me vetëdije do të kryejnë akte terroriste. Duke vëzhguar Ligjin Penal, parashikohet bashkëpunimi i personave për kryerjen e një vepre penale, si institucion i përgjithshëm i të drejtës penale. Megjithatë mendojmë që bashkëpunimi i personave që kanë kryer veprat penale të parashikuara nga Konventa, të cilësohet si i veçantë, pra si rrethanë cilësuese për kryerjen e akteve terroriste, kur këto vepra penale janë kryer sipas neneve 5, 6, 7 të Konventës (*Po aty, neni 9*).

Konventa parashikohet detyrimi, që të përcaktohet në legjislacionin e brendshëm përgjegjësia penale, civile dhe administrative e personave juridike, duke mos përjashtuar përgjegjësinë individuale, lidhur me pjesëmarrjen në veprat terroriste. Lidhur me këtë nen të Konventës theksojmë se ligji për përgjegjësinë penale, të personit juridik pritët të miratohet së shpejti nga Kuvendi (*Po aty, neni 10*). Po ashtu, Konventa përcaktohet se çdo shtet palë duhet të marrë masat e nevojshme, për të parashikuar veprat e përcaktuara në nenet 5, 6, 7 dhe 9 të kësaj Konvente, si të dënueshme, duke vendosur dënime efektive, proporcionale në raport me rrezikshmërinë e veprës, njëkohësisht edhe parandaluese (*Po aty, neni 11*).

Lidhur me këtë pikë të Konventës, theksojmë që bazat dhe parimet e legjislacionit tonë penal e procedural janë ato të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, të parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga shtetit ynë, si dhe të drejtësisë dhe humanizmit në caktimin e fajësisë dhe dhënien e dënimit (nenet 1/a , 1/c të Ligji Penal). Kështu që mendojmë se bazat dhe parimet e legjislacionit tonë penal dhe procedural duhet të zbatohen edhe në rastin e penalizmit të veprave të mësipërme, në caktimin e fajësisë dhe në dhënien e dënimit për autorët e këtyre veprave penale.

Në Konvent parashikohet që çdo shtet duhet të sigurojë që parashikimi dhe zbatimi i veprave penale të neneve 5, 6, 7 dhe 9 të kësaj Konvente duhet të bëhet në përputhje me respektimin e detyrimeve të Konventës Europiane për Liritë dhe të Drejtat Themelore të Njeriut, veçanërisht të së drejtës së shprehjes, të drejtës për t'u organizuar, lirisë fetare, Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, si dhe detyrimeve të tjera të së drejtës ndërkombëtare (*Po aty, neni 12*).

Konventa kërkon që shtetet pjesëmarrëse në të, të marrin masa të brendshme legislative, për të siguruar mbrojtjen, kompensimin dhe ndihmën e viktimave të terrorizmit dhe të familjeve të tyre (*Po aty, neni 13*). Pasi studiuam legjislacionin penal, vërejtëm se këto detyrime nuk janë të parashikuara. Për këto arsye mendojmë që kjo mbrojtje do të bëhej e mundur efektivisht me anë të një ligji të veçantë për mbrojtjen, kompensimin dhe ndihmën e viktimave të terrorizmit, pasi një ligj i tillë do të plotësonte edhe më mirë legjislacionin tonë penal.

Konventa përcaktohen masat e çdo shteti për të vendosur juridiksionin mbi veprat penale të parashikuara në këtë Konventë (*Po aty, neni 14*). Pasi studiuam legjislacionin penal dhe veçanërisht Ligjin Penal, vërejtëm se nuk parashikohen këto detyrime. Nga krahasimi që kemi ndërmarre lidhur me legjislacionin penal spanjoll, italian, anglez dhe francez, rezulton që asnjë nga këto shtete nuk e parashikon këtë detyrim të Konventës. Gjithsesi, jemi të mendimit që edhe për këtë detyrim të Konventës të bëhen ndryshime në Kodin Penal.

Në nenet 15 deri në 23 të Konventës kemi të bëjmë me dispozita të karakterit procedural penal. Kështu, nisur që nga përcaktimi i procedurave që duhet të ndiqen lidhur me detyrimin e shteteve palë për të hetuar; ekstradimin dhe ndjekjen penale të personave, duke përfshirë edhe bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar.

Në Konventë përcaktohet detyrimi që shtetet duhet t'u ofrojnë ndihmë të ndërsjellë juridike për hetimin, procedimin penal për veprat e parashikuara në nenet 5, 6, 7 dhe 9 të kësaj Konvente. Ky detyrim i shteteve do të realizohet nëpërmjet traktateve ose marrëveshjeve të ndërsjella; në mungesë të tyre do të zbatohet legjislacioni i brendshëm penal (*Po aty, neni 17*). Konventa parashikohet që çdo shtet, në territorin e të cilit ndodhet personi i akuzuar si autor i veprës penale, i cili ka juridiksion, sipas kësaj Konvente, për veprat penale të parashikuara në të, pavarësisht nëse vepra penale është kryer ose jo në territorin e këtij shteti, ky shtet ka detyrimin që këtë çështje t'ia parashtrijë pa vonesë organeve të tij të brendshme, me qëllim nisjen e procedimit penal të personit të akuzuar si autor të veprës penale (*Po aty, neni 18*).

Në Konventë parashikohet se veprat e përcaktuara në nenet 5, 6, 7 dhe 9 të jenë të ekstradueshme, duke përcaktuar në çdo traktat ose marrëveshje, këto vepra si të ekstradueshme. Edhe në rast se nuk janë parashikuar në traktate si të ekstradueshme, ato duhet të jenë të ekstradueshme. Kur midis palëve nuk ekziston një traktat ekstradimi, lidhur me veprat e neneve

5, 6, 7 dhe 9, kjo Konventë do të shërbejë si bazë ligjore për ekstradimin. Çdo shtet duhet të modifikojë traktatet dhe marrëveshjet e ekstradimit që kanë nënshkruar ndërmjet tyre, me qëllim që këto të jenë në përputhje me detyrimet e Konventës, pra veprat e parashikuara të jenë të ekstradueshme (*Po aty, neni 19*). Po ashtu, në Konventë përcaktohet detyrimi i shteteve që veprat penale të parashikuara nga Konventa nuk do të konsiderohen si politike për qëllime ekstradimi ose ndihme juridike të ndërsjellët, kur përbëjnë akte terroriste. Në këtë rast ekstradimi duhet të lejohet. Nisur nga Ligji Procedurjal Penal, veprat e kryera me karakter politik ose kur kryen për qëllime politike përbëjnë një nga rastet për moslejimin e ekstradimit. Për këtë arsye, sugjerojmë që kjo dispozitë të ndryshohet, duke pasqyruar këtë detyrim të Konventës (*Po aty, neni 20, parag. 1*). Në nenin 22 të Konventës parashikohet që autoritetet kompetente të një shteti, pa ndonjë kërkesë paraprake, t'i dërgojnë autoriteteve kompetente të një shteti tjetër informacion lidhur me hetimet dhe ndjekjen penale, kur çmohet se shpërndarja e një informacioni të tillë do t'i ndihmojë shtetet në vazhdimësinë e mëtejshme të hetimit ose të ndjekjes penale (*Po aty, neni 22*). Ky nen i Konventës forcon më shumë bashkëpunimin ndërmjet shteteve në luftën kundër terrorizmit. Duke ditur se sovraniteti i shteteve kufizon veprimet e një shteti të vetëm ose të një organizate ndërkombëtare të zgjidhë problemin e terrorizmit, shtetet duhet të reagojnë efektivisht, nëpërmjet bashkëpunimit midis tyre, ndaj terrorizmit. Me qëllim që të sigurohet mbrojtja nga terrorizmi dhe të ndiqen penalisht terroristët, lind nevoja e zgjerimit të bashkëpunimit ndërkombëtar midis shteteve.

2.2.2. Konventa kundër mbajtjes së pengjeve e miratuar nga OKB

Konventa Ndërkombëtare kundër Marrjes së Pengjeve (18 dhjetor 1979 në Nju Jork) (dhjetor 18, 1979 në Nju-Jork) Çdo Shtet Palë në këtë Konventë duke pasur parasysh "*Karta e OKB-së*", në lidhje me ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare dhe nxitjen e marrëdhënieve miqësore mes shteteve me qëllimet dhe parimet e bashkëpunimit, në veçanti njohin të drejtën e secilit për jetën, lirinë dhe sigurinë e personit nën "*Deklaratën Universale*" dhe "*Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike*", riafirmoi "*Kartën e OKB-së*" dhe "*të varet nga vendet Deklarata e Parimeve të Kartës së Parimeve të së Drejtës Ndërkombëtare lidhur me marrëdhënie miqësore dhe bashkëpunim* ", dhe rezolutave të tjera përkatëse të Asamblesë së Përgjithshme të përcaktuara në popuj të drejtat dhe vetëvendosje të barabartë, duke marrë parasysh marrjen e pengjeve është një vepër e shqetësim të madh për bashkësinë ndërkombëtare, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, çdo peng-marrja ose do të ndiqet penalisht ose të

ekstradohet, të bindur për nevojën urgjente për të zhvilluar bashkëpunimin ndërkombëtar midis vendeve të zhvillojë dhe miratojë masa efektive për të parandaluar të gjitha manifestimet e terrorizmit ndërkombëtar si akteve të marrjes së pengjeve, dhe ata që e kanë kryer këtë krim të ndiqen penalisht dhe të dënohet, ne kemi rënë dakord si vijon:

“Çdo person i cili zë, arreston dhe kërcënon të vrasë, plagosë ose të vazhdojë të ndalojë një person tjetër (në tekstin e mëtejme “peng”) si një kërcënim për të detyruar një palë të tretë, domethënë, një shtet, një organizatë ndërkombëtare ndërqeveritare, një person fizik ose juridik ose një grup personash, për të bërë ose për të mos kryer ndonjë veprim, si lirimi i pengjeve të shprehur apo të nënkuptuar kushte, peng-marrja është brenda fushës së kuptimit të kësaj Konvente (*Neni 1 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike*”).

Çdo Shtet Pale do t'i beje shkeljet e përcaktuara në nenin 1 të dënueshme me dënime të përshtatshme, të cilat do të marrin parasysh natyrën e rendë të këtyre shkeljeve (*Neni 2 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike*”).

2.2.3. Konventa për parandalimin dhe luftën ndaj krimeve kundër personave ndërkombëtarisht të mbrojtur, përfshirë agjentët diplomatik

Diplomacia është mirëmbajtja e marrëdhënieve në mes të shteteve, nëpërmjet marrëveshjeve si dhe metodave të zbatuara deri tek marrëveshja. Përndryshe diplomacia ndryshe thirret edhe arti i marrëveshjeve. Shtetet bisedojnë, (bashkëpunojnë) ndërmjet veti, mbrojnë interesat e tyre, njoftojnë njëra tjetrën, i përparojnë marrëdhëniet kryesisht nëpërmjet të dërguarve dhe pranimin e të dërguarve nga shteti përkatës. Të dërguarit janë misionar, ambasadorë ose grupe të dërguara. Shefi imisionit dhe personat diplomatik d.m.th Diplomatët, gëzojnë imunitet dhe të drejta të veçanta. Diplomacia themelet e saj i hasë që në kohë më të hershme ku shfaqet nevoja për marrëdhënie dhe marrëveshje (traktate ndërkombëtare), ndërmjet shteteve sidomos pas luftës së dytë botërore, dhe që atëherë vjen duke u përmirësuar rëndësia si dhe pozita e organit diplomatik. Me qëllim të realizimit sa më efikas të funksioneve diplomatike, Konventa e Vjenës dhe e drejta ndërkombëtare parashohin lehtësime, privilegje dhe imunitete për përfaqësuesit diplomatik dhe në shkallë të caktuar edhe për pjesëtarët tjerë të personelit diplomatik.

Sipas Konventës së Vjenës (*Nenet 21 dhe 26 të Konventës së Vjenëse vitit 1988*), shteti pranues ka për obligimin e ndërmarrjes së të gjitha masave të mundshme dhe të lejueshme me qëllim të fillimit sa më të shpejtë të punës në misionin diplomatik, apo nëse puna në mision është në vijim, të mundësoj të gjitha lehtësimet për kryerjen sa me më sukses të misionit diplomatik të akredituar në territorin e tij. Të gjithë anëtarët e misionit kanë të drejtë qarkullimi në shtetin pranues, përveç në raste kur bëhet fjalë për sigurinë kombëtare të shtetit pranues.

Privilegjet dhe imunitetet si dy nocione shumë të rëndësishme të së drejtësdit diplomatike dhe konsullare edhe pse shkojnë gjithnjë bashkarisht, si nocione çdonjëra kuptimin e vet. Me nocionin privilegjenën kuptohen përparsi dhe respekte të veçanta që itakojnë personelit diplomatik dhe misionit diplomatik, kurse me nocionin imunitete nën kuptohet përjashtimi apo lirimi i personelit të misionit diplomatik nga jurisdikcioni i shtetit pranues. Megjithatë, këto dy nocione në të shumtën e rasteve kanë pika të përbashkëta, pasi edhe privilegjet shpeshë herë reflektohen si imunitete dhe e kundërta.

Përfaqësuesit diplomatik janë të obliguar të respektojnë ligjet dhe sistemin juridik në shtetin pranues dhe në asnjë formë nuk duhet të përzihen në punë të brendshme të shtetit ku veprojnë. Me qëllim të efikasitetit në ushtrimin e funksioneve të tyre, Konventa e Vjenës parasheh lehtësime, imunitete dhe privilegje për përfaqësuesit diplomatik dhe përfunksionimin e misionit si tërësi. Edhe shteti pranues duhet t'ua lehtësoj punën diplomatëve që janë të akredituar në te, siç janë e drejta e lëvizjes dhe qarkullimit, e drejta e komunikimit, e sigurimit të nevojave të përditshme të tyre etj.

Konventa e Vjenës përcakton se përfaqësuesit diplomatik fillojnë të gëzojnë privilegjet dhe imunitetet nga momenti i hyrjes së tyre në territorin e shtetit ku janë të akredituar për të marrë detyrën e tyre (*Në nenin 39 të saj*). Kurse për personat tjerë të cilët gjinden në territorin e shtetit pranues, privilegjet dhe imunitetet fillojnë të shfrytëzohen nga momenti kur bëhet notifikimi i emërimit të tyre Ministrisë së Punëve të Jashtme apo ndonjë ministrie tjetër të autorizuar. Përfaqësuesve diplomatik, privilegjet dhe imunitetet pushojnë të vlejnjë në momentin kur ata përfundojnë funksionin e tyre, respektivisht kur lëshojnë territorin e shtetit ku edhe kanë qenë të akredituar. Nëse përfaqësuesi diplomatik edhe pas përfundimit të funksionit vazhdon edhe një kohë të qëndrojë në shtetin e pranimit, privilegjet dhe imunitetet vazhdojnë t'i vlejnjë edhe për një kohë të kuptueshme, e cila nuk mund të jetë shumë e gjatë. Pas

kësaj kohe të kuptueshme, privilegjet dhe imunitetet pushojnë të vlejné. Privilegjet dhe imunitetet për përfaqësuesin diplomatik vlejné edhe në rast të shpërthimit tëluftës në mes shtetit dërgues dhe shtetit pranues. Këto vlejné edhe për anëtarët e familjes së përfaqësuesit diplomatik në rast të vdekjes së tij gjer në kthimin e tyre në shtetin e vet.

2.2.4. Konventa për shtypjen e atentateve terroriste të kryera me dinamit dhe Konventa për shtypjen e financimit të terrorizmit: definimi i terrorizmit ndërkombëtar në këto konventa.

Definimi i “terrorizëm ndërkombëtar” i përfshin të gjitha format e veprimit terrorist, të paraqitura si terrorizëm shtetëror, respektivisht ai i stimuluar shtetëror dhe i drejtuar kundër një shteti tjetër e deri te format e ndryshme të bashkëpunimi tmidis grupeve të ndryshme terroriste ndërkombëtare. Këto forma të aktivitetit terrorist, zakonisht paraqiten në forma klasike të sulmeve terroriste kundër shtetit (në kuptim të përgjithshëm: përfaqësuesve shtetërorë, institucioneve, organeve, interesave shtetërore, etj.) ose shtetasve të huaj, gjegjësisht pronës së tyre, të kryeranë shtetin e autorëve ose në një shtet të tretë (*Laqueur, Terrorismus, Die globale Herausforderung, Ullstein 1987, fq. 338, 441*). Në të vërtetë, “terrorizmi ndërkombëtar” është më tepër një fenomen juridik sesa politik. Nga aspekti juridik, kriteret për përkufizimin e terrorizmit ndërkombëtar janë aq të gjera sa thuhet të gjitha aksionet terroriste do të mund të përfshiheshin në kompetenca të së drejtës ndërkombëtare. Mirëpo, nga aspekti shkencor një definim i tillë është i pa pranueshëm ngaqë krahas terrorizmit nacional do të paraqitej edhe ekzistenca e të ashtuquajturit “terrorizëm ndërkombëtar”. (*Konventa për shtypjen e atentateve terroriste të kryera me dinamit*). Për këtë arsye, në aspektin shkencor nuk mund të ketë “terrorizëm ndërkombëtar”, por ka terrorizëm nacional me sferë të zgjeruar të veprimit ndërkombëtar (*Georgios Kaouras, Terrorismus, historische und politische Komponenten des terroristischen Phänomens, Europäische Hochschulschriften, Peter Lang, Frankfurt am Main 1993, fq. 82*). Deri tash është bërë një seri përpjekjesh për përcaktimin juridik të terrorizmit ndërkombëtar. Në këtë aspekt, përkufizimi më i thjeshtë e shpjegon terrorizmin ndërkombëtar në kontest të konsekuencave të qarta ndërshtetërore.

Këtu përfshihen aktet e dhunës terroriste, të cilat i kalojnë kufijtë e një shteti ose ato me përfshirje të qarta ndërkombëtare:

- kur terroristët udhëtojnë në një shtet të huaj me qëllim që atje ta godasin objektin e tyre;

- kur viktima ka të bëjë me elementin ose raportet e ndryshme ndërkombëtare (shtetasit e huaj, të akredituarit e ndryshëm diplomatikë, zyrtarë të misioneve të ndryshme, etj.);
- kur terroristët i sulmojnë aeroportet, përkatësisht avionët ose i detyrojnë ato për të aterruar në një shtet tjetër;
- kur terroristët i sulmojnë institucionet e huaja shëndetësore, arsimore, kulturore, fetare, etj.

Njëri nga përkufizimet më të rëndësishme është ai i shkencëtarit, Brian M. Jenkins, i cili e përkufizon terrorizmin ndërkombëtar në këtë mënyrë:

“Terrorizmi ndërkombëtar mund të paraqitet si akt i dhunës ose si serie akteve të dhunës së ushtruar në kundërshtim me të drejtën diplomatike ndërkombëtare dhe rregullat e luftës. Terrorizmi ndërkombëtar nuk është formë klasike e zhvillimit të luftës së armatosur ashtu si e prezantojnë grupet e ndryshme revolucionare ose disidente, por është formë e re e zhvillimit të luftës pa territor dhe ushtri. Kjo do të thotë se për dallim nga format klasike të zhvillimit të luftës së armatosur, terrorizmi nuk kufizohet vetëm në një territor të caktuar. Terrorizmi ndërkombëtar nuk rrespekton as popull e as shtet neutral dhe mund të zbatohet në çdo pjesë të botës”. (*Jenkins, International Terrorism: A Blance Sheet, The International Institute for Strategic Studies, London, Juli/August 1975; Franz Wörderman, Terrorismus, Motive, Täter, Strategien, München 1977, fq. 105*).

Ndërkaq, Smith terrorizmin ndërkombëtar e argumenton: “Terrorizmi është ndërkombëtar nëse terroristi ka përkatësi shtetërore tjetër nga të paktën njëra viktimë e tij... Terrorizmi ndërkombëtar mund të kryhet, si në raporte politike të brendshme, ashtu edhe në ato të jashtme. Në rastin e parë, terroristët kanë për qëllim parësor arritjen e koncesioneve të ndryshme politike ose rrëzimin e qeverive të tyre. Ndërsa, në rastin e dytë, qëllimi kryesor i terroristit është ndërrimi i raporteve të caktuara ndërkombëtare” (*Smith W. H., International Terrorism. A Political Analysis. Në librin : The Year Book of World Affairs. Vol. 31. 1977, fq. 140 – 141*).

Për Williksonin, terrorizmi ndërkombëtar ka të bëjë: “Me eksportimin e dhunës politike jashtë territorit të shtetit të terroristëve, me qëllim të vrasjeve ose plagosjeve të shtetasve të huaj, të cilët njihërit janë edhe të pafajshëm dhe nuk kanë asgjë të përbashkët me luftën e terroristëve. Terrorizmi ndërkombëtar ka të bëjë edhe me formimin e lidhjeve dhe formave të tjera të

bashkëpunimit ndërnacionalterrorist me qëllim të koordinimit të aktiviteteve të ndryshme terroristendërkombëtare” (*Paul. Political Terrorism. London - Basingstoke: Macmillan Press. 1974, fq. 122*).

Në bazë të këtyre përkufizimeve të ofruara mund të konkludohet se veprimterrorist ndërkombëtar është ai veprim i dhunës së motivuar politike, i orientuar nëdrejtim të influencimit, përkatësisht të ndërrimit të qëndrimeve ose raporteve të caktuarandërkombëtare.

2.2.5. Konventa për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e të ardhurave të kriminit dhe financimin e terrorizmit

Kjo Konventë është shumë e rëndësishme në kuadrin e luftës kundër terrorizmit. Konventa përcakton një sërë rregullash, duke përfshirë të gjitha fazat e procedurave që nga hetimi paraprak e deri në marrjen e vendimit për masën e konfiskimit, si dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, ndërmjet shteteve, të cilët nëpërmjet mekanizmave efektive të parandalojnë të ardhurat, produkt i veprimtarisë së paligjshme kriminale. Shtetet palë që do ta ratifikojnë atë janë të detyruara të ndërmarrin masa legjislative në nivel kombëtar në legjislacionin e tyre të brendshëm, në mënyrë që të rregullohen ligjërisht çështje që kanë të bëjnë me pronësinë, të ardhurat, përfitimet që kanë ardhur dhe janë fituar si rezultat i veprimtarisë kriminale terroriste, me qëllim për të parandaluar qarkullimin dhe riqarkullimin e këtyre të ardhurave, si dhe dhënien në pronësi, disponimin, posedimin, tjetërsimin dhe kalimin e tagrave të pronësisë të fituar me anë të përdorimit të të ardhurave të papastra, nga veprimtaria kriminale, personave të tjerë.

Konventa përcakton detyrimin që çdo shtet palë i Konventës të përshtatë masa të përshtatshme legjislative, në mënyrë që të bëjë të mundur zbatimin e dispozitave të krerëve III, IV, V të Konventës (*Konventa për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e të ardhurave të kriminit dhe financimin e terrorizmit, neni 2*). Konventa parashikon detyrimin e shteteve për të marrë masa të brendshme legjislative, në mënyrë që të bëhet e mundur konfiskimi i mjeteve, pronës dhe të ardhurave, të cilat janë përfituar nga veprimtaria kriminale terroriste (*Po aty, neni 3, parag. 1*). Po ashtu në Konventë përcaktohet shprehimisht detyrimi i shteteve që me anë të masave legjislative në legjislacionin e brendshëm të parashikojnë që autori i veprës penale të tregojë origjinën e të ardhurave ose të pronësisë, e cila është objekt konfiskimi (*Po aty, neni 3, parag. 4*). Në Konventën përcaktohen masat që duhet të marrë çdo shtet, në mënyrë që të bëhet i mundur identifikimi, gjetja, kapja dhe ndalimi i pronës, objekt konfiskimi (*Po aty, neni 4*).

Konventa përcakton detyrimin e shteteve për të përcaktuar në legjislacionin e brendshëm, rrethin e pronave ose të të ardhurave, mbi të cilat do të shtrihen efektet e konfiskimit (*Po aty, neni 5*). Konventa parashikon si detyrim masat që duhet të marrë çdo shtet, për të administruar si duhet pasurinë ose të ardhurat e konfiskuara (*Po aty, neni 6*). Në Konventë përcaktohet që çdo shtet duhet të marrë masa legjislative, në mënyrë që të autorizojë gjykatat ose autoritete të tjera kompetente që të urdhërojnë ndalimin e dosjeve ose llogarive bankare ose financiare, në banka, në mënyrë që të ndërmerren veprimet e parashikuara në nenet 3, 4 dhe 5 të Konventës (*Po aty, neni 7*). Konventa parashikon detyrimin që shtetet, të cilat do të ratifikojnë Konventën, të parashikojnë që të dëmshpërblehen ligjërisht palët ose personat e interesuar, të cilët janë cenuar nga masat e marra konform neneve 3, 4 dhe 5 të Konventës, me qëllim që të vihen në vend të drejtat e tyre të ligjshme (*Po aty, neni 8*).

Konventa përcakton që shtetet palë të saj të parashikojnë në legjislacionin e brendshëm veprat e mëposhtme penale, kur këto janë kryer me dashje:

- Tjetërsimi ose transferimi i pronës, duke ditur që kjo pronë është fituar si rezultat i veprimtarisë kriminale terroriste, me qëllimin për të fshehur origjinën e vërtetë të kësaj prone ose për të ndihmuar personin, i cili është përfshirë në kryerjen e veprave penale;
- Fshehja ose ndryshimi i natyrës së vërtetë, burimi, vendi, disponimi i pronës dhe i të drejtave të tjera të pronësisë, duke e ditur që një pronë e tillë është fituar si rezultat i veprimtarisë kriminale;
- Blerja, posedimi ose përdorimi i pronës, kur dihet se kjo është fituar si rezultat i veprimtarisë kriminale;
- Pjesëmarrja, bashkëpunimi, tentativa dhe dhënia e ndihmës për të kryer ose për të lehtësuar kryerjen e veprave të mësipërme penale (*Po aty, neni 9*).

Konventa parashikon detyrimin e çdo shteti për të garantuar përgjegjësinë penale të personit juridik, për kryerjen e veprave të pastrimit të parave, sipas neneve të Konventës, kur veprat e mësipërme janë kryer nga personi fizik, në interes të personit juridik, i cili ka një pozitë drejtuese në të ose:

- është përfaqësues i personit juridik;
- ka të drejtën e vendimmarrjes në interes të personit juridik;

- ka të drejtën për të kryer kontrollin e veprimtarisë së personit juridik. Më tej ky nen parashikon që përgjegjësia penale ndaj personit juridik nuk përjashton përgjegjësinë penale të personit fizik, i cili ka një pozitë drejtuese, brenda personit juridik dhe vepron për llogari të tij. Ky nen i Konventës përcakton që edhe personi natyror do të përgjigjet penalisht për veprat penale të pastrimit të parave (*Po aty, neni 10*).

Në Konventë parashikohet që çdo shtet në dhënien e vendimit përfundimtar për dënimin e personit juridik dhe fizik, duhet të marrë parasysh edhe dhënien e vendimit përfundimtar nga shtetet e tjera, në lidhje me veprat penale të përcaktuara nga Konventa (*Po aty, neni 11*).

Konventa përcakton që çdo shtet duhet të ngrejë një strukturë ose një organ të veçantë, e cila do të quhet Zyra e Informacionit Financiar. Kjo zyrë do të ketë autoritetin, që në zbatim të veprimtarisë së saj të ketë drejtpërdrejt ose tërthorazi akses, lidhur me informacionet financiare dhe njëkohësisht të analizojë raportet financiare të subjekteve të ndryshëm, të cilët dyshohen se janë implikuar në veprat penale terroriste (*Po aty, neni 12*). Konventa parashikon që çdo shtet të marrë masa të nevojshme legislative në mënyrë që të vendosë një regjim rregullator, monitorues dhe mbikëqyrës, për të parandaluar pastrimin e parave që vijnë si rezultat i veprimtarisë kriminale terroriste. Në këtë kontekst, çdo shtet duhet që t'i kërkojë personave fizike ose juridike të cilët janë angazhuar në veprimtari, të cilat, ka të ngjarë, që të përdoren për pastrimin e parave, të bëjnë deklarime të përcaktuara paraprakisht, në akte ligjore ose nënligjore përkatëse (*Po aty, neni 13*).

2.3. Luftimi i terrorizmit

2.3.1. Masat për parandalimin e terrorizmit

Në përputhje me aktet ndërkombëtare dhe angazhimet që shoqëria Kosovare kishte marrë në luftën kundër akteve terroriste, Kosova ndërmori një sërë reformash institucionale dhe ligjore. Kështu, Kuvendi i Kosovës miratoi ligjin për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Ky ligj ishte pjesë e reformës ligjore, në zbatim të Konventës së OKB-së dhe Rezolutës së KS-së, i cili kishte si qëllim parandalimin dhe goditjen jo vetëm të subjekteve terroristë por edhe të atyre që mbështesin dhe financojnë terrorizmin (*Ligji nr. 03/1-196 “Për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit”*). Kjo do të realizohej nëpërmjet masave kundër pasurisë si bllokim (Është ndalimi i përkohshëm i çdo transaksioni ose

lëvizje e fondeve sipas procedurave të parashikuara nga organet kompetente. Këto ngelen në pronësi të personave që kanë të drejtë mbi to në momentin e vendosjes së masës së bllokimit.), ngrirje, sekuestrim (Sekuestrimi është ndalimi i çdo transaksioni ose tjetërsimi të fondeve ose pasurive sipas procedurave të marra nga organet kompetente. Pas vendosjes së sekuestros organet përgjegjëse ushtrojnë të drejtat e kontrollit mbi fondet dhe pasuritë) dhe konfiskim i çfarëdo lloj pasurie apo fondi të ligjshëm apo të paligjshëm të personave të shpallur si terroristë apo financues duke pasur parasysh këtu rezolutat e OKB-së apo akteve të tjera ndërkombëtare. *(Për më shumë shikodispozitat e ligjit Për masat kundër financimit të terrorizmit).*

Këto masa kundër pasurisë drejtohen vetëm ndaj personave të shpallur për vepra të terrorizmit apo për financim të tij sipas rezolutave të KS-së të OKB-së apo marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare ku Kosova është pjesë, pas përfshirjes në listë nga Këshilli i Ministrave. Një rol shumë të madh luan këtu edhe Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, e cila merret me grumbullimin, përpunim, sistemim, analiza, shkëmbim, paraqitjen e të dhënave mbi zbatimin e masave kundër terrorizmit, si organi përgjegjës në zbatim edhe të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. *(Për më shumë shiko, dispozitat e ligjit “Kundër financimit të terrorizmit”).*

Qëllimi i këtij ligji, përveç të tjerave është edhe lufta kundër financimit të terrorizmit, nëpërmjet verifikimit nga institucionet financiare dhe autoritetet mbikëqyrëse të gjitha transaksioneve apo veprimeve financiare të dyshimta. Organi i vetëm përgjegjës për caktimin e masave kundër pasurisë është Ministri i Financave, i cili me urdhër vendos një nga masat e parashikuara në ligj siç mund të jetë bllokim, sekuestrim, ngrirje. Vendimi i marrë nga Ministri i Financave është një akt i ankimeshëm në gjykatë sipas rregullave të përgjithshme të ankimit, por barra e provës në këtë proces civil të sekuestrimit i bie personit të shpallur, ndaj pasurisë së të cilit janë caktuar masa të tilla si bllokim, ngrirje apo sekuestro *(Shea, “NATO and Terrorism”, në “RUSI Journal” (Royal United Services Institute for Defence and Security Studies), Vëll. 174, Nr. 2, Prill 2002).*

Ligji Anti-mafia, sa i përket masave kundër pasurisë ndaj personave që janë pjesëmarrës në organizata terroriste nuk është miratuar ende. Risetë e ligjit Anti-mafia janë të lidhura me garancitë procedurale, standardin e provueshmërisë, por jo me masat kundër pasurisë së

personave që kryejnë akte terroriste (*Krasniqi, vep. e cit., 2005 fq. 142*). Për parandalimin, izolimin, kontrollin dhe eliminimin e terrorizmit ndërkombëtar duhet :

- Bashkëpunim ndërmjet Shteteve, Organizatave dhe Institucioneve Ndërkombëtare në miratimin dhe respektimin e Konventave, Marrëveshjeve, Ligjeve Ndërkombëtare anti-terrorizëm;
- Luftimi i drejtëpërdrejtë ushtarak nga ajri, toka, deti i Organizatave Terroriste në vendet e origjinës;
- Mbështetje politike, ekonomike, financiare për shtetet e vogla, të dobëta dhe të rrezikuara nga propaganda e veprimet terroriste që të drejtohen drejt rrugës perëndimore;
- Vigjilencë maksimale në të gjithë territoret e shteteve aleate në luftën kundër terrorizmit duke shfrytëzuar Agjencitë e Inteligjencës të shteteve të fuqishme për të marrë informacione mbi sulmet e mundëshme terroriste;
- Kujdes dhe kontroll maksimal në teknologji, informacion dhe luftën përkundrejt “Terrorizmit Kibernetik”;
- Bashkëpunimi ndërkombëtar ndërmjet Organizatave të Sigurisë si Interpoli, Europoli dhe Institucioneve të tjera të Sigurisë dhe Mbrojtjes;
- Zbatimi dhe respektimi i Konventave dhe Protokolleve kundër-terrorizmit të OKB-së që janë në fuqi, negocimi dhe implementimi i Konventa të reja anti-terrorizëm dhe sigurisht miratimi dhe respektimi i Rezolutave të Këshillit të Sigurimit për përmirësimin e Sigurisë Ndërkombëtare (*Po aty, fq. 143*).

Në përfundim, masat e luftës kundër-terrorizmit duhet të bazohet tek mjetet diplomatike si arbitrazhi, negociatat, sanksionet diplomatike, embargot ekonomike të cilat do të ndihmonin më shumë për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, ndoshta më shumë se çdo veprimtari ushtarake. Në marrëdhëniet ndërkombëtare lufta kundër së “keqes” së përgjithëshme fitohet me partneritet, bashkëpunim ndërkombëtar ndërmjet Organizatave Ndërkombëtare si OKB, BE, NATO, OSBE dhe ndërmjet shteteve të fuqishme të botës si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Rusia, Britania e Madhe, Gjermania, Italia, Franca etj. Qytetërimet botërore ndryshojnë nga njëri-tjetri në bazë të historisë, kulturës, fesë, traditës, politikës, ekonomisë, sigurisht këto ndryshime sjellin edhe konfliktet dhe fenomenin e terrorizmit ndërkombëtar. Lufta përkundrejt

terrorizmit ndërkombëtar nuk do të fitohet në kohë afatshkurtër, por mund të parandalohet dhe mbahet nën kontroll në aspektin afatgjatë.

2.3.2. Masat për zbulimin e kryerësve të akteve terroriste

Masat për zbulimin dhe luftimin e akteve të terrorizmit kërkojnë një qasje gjithëpërfshirëse dhe strategjike, duke u bazuar dhe mbështetur tek një gamë e gjerë politikash dhe masash. Qasjet strategjike në luftën kundër terrorizmit shpesh përfshijnë disa objektiva, duke trajtuar stadi të ndryshme kronologjike, sipas ndodhjes së terrorizmit. Në shumë vende, një qasje strategjike ndaj terrorizmit është e përfshirë në politikën kombëtare të sigurimit. Disa vende dhe organizata të tjera kanë hartuar një dokument specifik, i cili është i disponueshëm për publikun, ku përshkruhet strategjia përkatëse për luftën kundër terrorizmit. Këto dokumente strategjike shpesh përdorin terminologji të ngjashme, por me variacione për sa i përket kuptimit aktual të termave. Hetimi dhe ndjekja e rasteve kriminale të lidhura me terrorizmin, duke përfshirë nxitjen dhe rekrutimin për qëllime terrorizmi duhet të bazohen mbi fakte specifike, duhet të garantojnë proces dhe gjykim të drejtë, si edhe të jenë në përputhje me ndalimin absolut të torturës apo çdo trajtim apo ndëshkim tjetër mizor, çnjerëzor apo degradues, me të drejtën e jetës dhe të drejtën e lirisë dhe sigurisë (*Human Rights in Counterterrorism Investigations: A Practical Manual for Law Enforcement Officers [Të Drejtat e njeriut në hetimet kundër terrorizmit: Manual praktik për punonjësit e organeve të rendit]*, (Varshavë: OSBE/ODIHR, 2013).

Megjithatë, natyra e terrorizmit, si një krim i rëndë është e tillë që policia, apo agjenci të tjera kompetente shtetërore duhet të përdorin teknika të posaçme hetimi (SITs), si fjala vjen, përdorimi i agentëve të fshehtë, mbikëqyrja dhe përgjimi i komunikimit. Teknikat e posaçme të hetimit përfshijnë ndërhyrje të rënda në aspektet e të drejtave të njeriut, në veçanti të drejtat për gjykim të drejtë dhe fshehtësi.

Rrjedhimisht, përdorimi i këtyre teknikave duhet të jetë:

- I kufizuar tek rastet e rënda dhe në përpjesëtim me seriozitetin e çështjes nën hetim; dhe
- I bazuar tek ligjet që përcaktojnë dhe përkufizojnë qartë mekanizmat për autorizimin paraprak, mbikëqyrjen, shqyrtimin ex post facto dhe llogaridhënien nën dritën e të drejtave të njeriut, në mënyrë të veçantë të drejtës për gjykim të drejtë dhe shtetit ligjor (*Këshilli i Evropës, Rekomandimi (2005)10 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të*

Evropës mbi “Teknikat speciale të hetimit” në lidhje me krimet e rënda, duke përfshirë aktet e terrorizmit, Strasburg, 20 prill 2005).

2.3.3. Politikat ndëshkimore dhe luftimi i terrorizmit

Lufta kundër terrorizmit ndërkombëtar duhet bazuar në pengimin dhe moslejimin e organizatve terroriste që të zotërojnë dhe më pas të përdorin Armë të Shkatërrimit në Masë si Armët Bërthamore, Biologjike dhe Kimike, ky fakt do të ishte tejet i rrezikshëm për egzistencën e njerëzimit. Terrorizmi Ndërkombëtar, në vitin 2015 manifeston dhunën, terrorin dhe vrasjet masive më të përgjakëshme në të gjithë popullsinë e globit. Aktet terroriste organizohen, planifikohen, financohen dhe kryen nga “*Organizatrat Terroriste Ndërkombëtare*”, të cilat qëllimin e përbashkët e gjejnë tek destabilizimi i Rendit Ndërkombëtar. Në librin “*International Terrorism: A New Mode of Conflict*”, studiuesi Brain M. Jenkins thekson: “*Terrorizmi ndërkombëtar mund të krahasohet me fillimin e një Luftë të III Botërore*”.

Për të arritur qëllimet e tyre terroriste, si armë kryesore përdorin vrasjen dhe përhapjen e ndjenjës së terrorit në popullsi me mjete, forma dhe mënyra të ndryshme por që kanë të njëjtën pasojë gjakderdhjen e njerëzve të pafajshëm, ngjarje që krijojnë probleme, kriza, konflikte, luftëra në rajone të ndryshme të botës veçanërisht në Lindjen e Mesme. Këto grupe terroriste përbëhen nga nacionalistë, ekstremistë, revolucionar, terroristë, radikalë politik, fetar, ideologjik (Jenkins, “*The Study of Terrorism: Definitional Problems*”, RAND Corporation, Dhjetor 1980).

Shtetet kanë detyrimin e sigurimit të mbrojtjes kundrejt akteve terroriste dhe kjo kërkon prej tyre vendosjen e një theksi të posaçëm tek parandalimi i terrorizmit. Kjo pasqyrohet në detyrimet e tyre ndërkombëtare juridike dhe në angazhimet politike. Strategjia globale e Kombeve të Bashkuara për luftën kundër terrorizmit përcakton më së shumti një qasje holistike në lidhje me antiterrorizmin, e cila përfshin:

- Masa për trajtimin e kushteve që çojnë në përhapjen e terrorizmit;
- Masa për parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit; dhe
- Masa për garantimin e respektimit të të drejtave të njeriut për të gjithë individët dhe sundimin e ligjit, si baza themelore e luftës kundër terrorizmit.

Si mjet primar në luftën kundër terrorizmit në përgjithësi, para së gjithash përmenden sanksionet penale në formë të dënimit me dhunën e tyre dhe natyrën represive. Zbatimi i masave

repressive në formën primitive zakonisht kanë qenë të përcjella me forma të ndryshme të dhunës si dhe me metodat më të vrazhda fizike dhe psikike të dhunës. Natyrisht edhe evoluimi i tyre ishte i karakterit ndryshues duke pas parasysh shkallën e zhvillimit historik dhe karakterin shoqërorë të shoqërisë në të cilin ato ishin paraparë dhe ishin zbatuar (*Hoffman, "Terrorism and ĘMD: Some Preliminary Hypotheses", në "Non-Proliferation Review", Vëll. 4, Nr. 3, Pranverë-Verë 1997*).

Ndikim pozitiv në luftën kunder krimit të organizuar pati edhe fillimi i dënimeve me burgime të rënda i personave të kapur për trafikë të paligjshme, e vepra të tjera të rënda të lidhura me krimin e organizuar.

2.3.4. Format e luftimit të krimit të organizuar

Një nga aspektet që do të bënin efektive luftën kundër terrorizmit është edhe goditja e financimeve të terrorizmit. Në shumë raste ekziston terrorizmi ndërkombëtar i sponsorizuar nga shteti. Financimi i akteve terroriste bëhet me mënyra nga më të ndryshmet. Kështu një shtet mund të pajisë, të stërvitë, të drejtojë dhe të sigurojë lehtësira për veprimtarinë terroriste.

Organizatave terroriste mund të kenë burime financimi, armatimi, stërvitjeje dhe logjistike nga shtete të ndryshme. Me qëllimin goditjen dhe parandalimin e financimit të terrorizmit janë bërë shumë përpjekje, për ta ngritur luftën kundër dukurive të terrorizmit në lartësinë e akteve ndërkombëtare. Një prej këtyre akteve është edhe Konventa Ndërkombëtare për Ndalimin e Financimit të Terrorizmit (Nju Jork: 1999), e hyrë në fuqi në vitin 2002. Sipas kësaj Konvente parashikohej dënimi i sigurimit ose grumbullimit të paligjshëm dhe i vullnetshëm i fondeve ose mjeteve financiare të drejtpërdrejta ose të tërthorta. Nëse këto veprime do të kryheshin me synimin që ato të përdoren ose me dijeninë se ato do të përdoren për kryerjen e shkeljeve të parashikuara në Konventë ose një akt i synuar të shkaktojë vdekjen ose dëmtime serioze trupore ndaj një civili ose personi tjetër, për të frikësuar një popullsi, ose për të detyruar një qeveri ose organizatë ndërkombëtare. Masat që një shtet duhet të përdorë për të parandaluar aktet terroriste dhe krimin e organizuar janë:

- Të marrin masat e nevojshme, në pajtim me parimet ligjore të brendshme, për diktimin dhe ngrirjen, kapjen ose konfiskimin e fondeve që përdoren ose janë caktuar të përdoren për qëllime të shkeljeve të parashikuara në Konventë;

- Të vendosin juridiksionin mbi shkeljet e parashikuara;
- Të dënojnë penalisht këto shkelje;
- Të arrestojnë autorët, t'i procedojnë ose ekstradojnë ata;
- Të bashkëpunojnë për masat parandaluese dhe kundërmasat të shkëmbejnë informacion dhe provat e nevojshme për ndjekjen penale (*Latifi, Elezi, Hysi, vep. e cit., fq. 191*).

Sulmet e 11 Shtatorit kanë ngjallur një interesim të ri, për traktatet ndërkombëtare për forcimin e ligjit dhe të rendit kundër terrorizmit, kudo në botë e veçanërisht në SHBA. Këto akte ndërkombëtare, për të qenë efektive, duhet të përkufizojnë terrorizmin në mënyrë të veçantë, në të gjitha rastet dhe të mbështeten në zbatimin e ligjit të brendshëm.

Masa të shumta kundër financimit të terrorizmit ka marrë edhe Bashkimi Europian. Heqja e barrierave nëpër Europë, jo vetëm ka ndihmuar bizneset legjitime, por, gjithashtu, ka siguruar rritjen e mundësive për krimin financiar dhe pastrimin e parave. Zgjerimi i Bashkimit Europian dhe paraqitja e eksedit të ri të shteteve do të thotë se krimi financiar ndërkombëtar është duke marrë përmasa të mëdha në ekonominë globale (*Direktiva 2001/97/EC e Bashkimit Europian*).

Ndërprerja e parave ndaj terroristëve është një nga përparësitë e strategjisë europiane kundër terrorizmit. Brenda këtij konteksti pastrimi i parave përbën një tjetër sfidë. Direktiva europiane e pastrimit të parave përcaktonte zgjerimin e detyrimeve, për të njoftuar transaksione të dyshimta, në lidhje me profesione jofinanciare dhe sektorë të tjerë, në procesin e pastrimit të parave. Rregulla të reja do të mbulojnë edhe profesione që nuk janë përcaktuar në legjislacionin e antipastrimit të parave të shteteve të Bashkuara, si ekonomistët, auditët, dhe avokatët.

Një organizëm ndërkombëtar në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit është edhe Task-Force Veprimi Financiar (FATF) në të cilin, një rol të rëndësishëm luan edhe Komisioni Europian. FATF ka përcaktuar rekomandime, të cilat duhet të konsiderohen si standarde ndërkombëtare në luftën kundër financimit të terrorizmit. Një nga gjërat që nuk të shkon ndërmend, kur jemi duke menduar për terrorizmin dhe financimin e terrorizmit, është falsifikimi i të mirave. Duhet marrë në konsideratë se një grup i gjerë organizatash terroriste po përfitojnë nga prodhimi i falsifikuar i të mirave. Falsifikimi përfshin kompakt disqe, rroba ose kozmetikë, disa lloje ilaçesh, ushqim për fëmijë, pjesë këmbimi makinash, madje edhe aeroplanësh (*Latifi, Elezi, Hysi, vep. e cit., fq. 257*).

Terroristët po përdorin internetin si mjet për të komanduar dhe kontrolluar veprimet e tyre. Njëkohësisht, ato e përdorin internetin, si mjet propagandues për të shpërndarë mesazhet e tyre dhe për t'i bërë presion qeverive. Në këtë prizëm, një tjetër Konventë që ka për qëllim të zgjerojë përpjekjet e bashkësisë europiane në luftën kundër terrorizmit është edhe Konventa për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e të Ardhurave të Krimin dhe Financimin e Terrorizmit. Le të njihemi konkretisht me detyrimet e kësaj Konvente.

Sipas Strategjisë Europiane të Sigurisë (“Një reagim evropian mbi terrorizmin global”, Mirjam Dittrich, Janar 2005), terrorizmi global përbën një kërcënim strategjik dhe është e nevojshme ta luftosh atë. Nevoja e përdorimit të forcave ushtarake do të përbënte një metodë gjithëpërfshirëse në luftën kundër terrorizmit. Nisur nga sulmet e Madridit të marsit 2004, Këshilli i Europës përcaktoi një kornizë politikash, duke përfshirë Sigurimin Evropian dhe Politikën e Mbrojtjes në luftën kundër terrorizmit. Në këtë kornizë parashikoheshin 4 fusha kryesore, të cilat mund të kontribuonin në luftën kundër terrorizmit: parandalimi, mbrojtja, menaxhimi i pasojave dhe mbështetje ndaj palëve të treta. Politikat në këtë kornizë bazoheshin në parimet e solidaritetit midis shteteve të BE-së. Bashkëpunimi, në mbështetje të qëllimeve të përbashkëta në luftën kundër terrorizmit, do të shtrihej edhe në kontributin e forcave ushtarake. Por ky bashkëpunim duhej të përgatitej duke pasur parasysh mbrojtjen e popullsisë civile ndaj sulmeve terroriste, duke përcaktuar procedura dhe kritere për balancën midis operacioneve ushtarake dhe mbrojtjes së të drejtave të popullsisë civile.

Sulmet e mëdha terroriste janë kryer në tokën evropiane dhe më gjerë. Investimet në rritje dhe solidariteti në antiterrorizëm janë thelbësore. BE prandaj do të inkurajojë shkëmbim më të madh të informacionit dhe inteligjencë bashkëpunimi ndërmjet Shteteve Anëtare dhe agjencive të BE-së. Kjo përfshin të përbashkëta alarme mbi ekstremizmin e dhunshëm, rrjetet terroriste dhe terroristët e huaj luftëtarët, si dhe monitorimin dhe heqjen e përmbajtjes së paligjshme nga media. Së bashku, BE do të mbështesë rimëkëmbjen e shpejtë të Shteteve Anëtare në rast sulmesh përmes përpjekjeve të zgjeruara për sigurinë e furnizimit, mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe forcimin e vullnetarizmit korniza për menaxhimin e krizave kibernetike. Shtetet Anëtare do të thellojnë punën në arsim, komunikimi, kultura, rinia dhe sporti për t'iu kundërvënë ekstremizmit të dhunshëm. (*European Union Global Strategy, A Global Strategy for the European Union's Foreign And Security Policy, 2016, fq 21*). BE do të punojë në kundër-

radikalizim duke zgjeruar partneritetin tonë me shoqëria civile, aktorët socialë, sektori privat dhe viktimat e terrorizmit, si dhe përmes dialogut ndërfaqësor dhe ndër-kulturor. Më e rëndësishmja nga të gjitha, BE-ja do t'i përmbahet vlerave të saj nga brenda dhe nga jashtë: kjo është antidoti më i fortë që kemi kundër ekstremizmit të dhunshëm. BE gjithashtu do të më tej zhvillojnë bashkëpunim antiterrorizëm në përputhje me të drejtat e njeriut me Veriun Afrikë, Lindja e Mesme, Ballkani Perëndimor dhe Turqia, ndër të tjera, dhe punojnë me partnerë në të gjithë botën për të ndarë praktikën më të mirë dhe për të zhvilluar programe të përbashkëta për luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit. (*European Union Global Strategy, A Global Strategy for the European Union's Foreign And Security Policy, 2016, fq 21*).

Në nenin 43 të Kushtetutës Evropiane e cila plotëson nenin V të Traktatit të Washingtonit për NATO-n theksohet se nëse një prej shteteve anëtare është viktimë e sulmeve terroriste, atëherë shtetet e tjera anëtare duhet të mobilizojnë të gjitha instrumentet, që ato kanë në dispozicion, duke përfshirë edhe forcat ushtarake (*Latifi, Elezi, Hysi, vep. e cit., fq. 257*). Pra, nismat më të fundit të Bashkimit Europian, për të zhvilluar më tej kontributin e forcave ushtarake në luftën kundër terrorizmit, tregojnë qëndrimin dhe angazhimin e Europës, në ndjekjen e qëllimeve antiterroriste, nëpërmjet politikave gjithëpërfshirëse, pra, përligjen e përdorimit të forcave ushtarake.

2.3.5. Mekanizmi institucional në Republikën e Kosovës në luftën kundër terrorizmit

Kompetencat e secilit institucion relevant të përfshirë në hartimin dhe zbatimin e politikave shtetërore në fushën kundër terrorizmit janë por nuk kufizohen në institucione: (*Strategjia Shtetërore kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022, Prishtinë, 2017, fq. 11-15*).

Ministria e Punëve të Brendshme.- MPB është institucioni përgjegjës qeveritar që udhëheq në hartimin dhe monitorimin e politikave dhe legjislativitetit në fushën e sigurisë së përgjithshme dhe terrorizmit. Përmes mekanizma dhe agjencive të saj, MPB ndërmerr aktivitetet në parandalimin, mbrojtjen, ndjekjen dhe reagimin ndaj të gjitha aktiviteteve terroriste.

Koordinatori Nacional kundër Terrorizmit.- Koordinatorin Nacional kundër Terrorizmit është Ministri i Punëve të Brendshme, ose personi i autorizuar nga ai, i cili është përgjegjës të

bashkërendojë, udhëzojë, monitorojë dhe të raportojë për zbatimin e politikave, aktiviteteve dhe veprimeve në lidhje me Strategjinë kundër Terrorizmit.

Sekretariati i Strategjive.-Sekretariati i Strategjive në MPB ka për detyrë të monitoroj në baza të rregullta zbatimin e strategjisë duke mbledhur dhe analizuar të dhëna rreth zbatimit të aktiviteteve të planit të veprimit, si dhe hartuar raportet perioditike dhe vlerësuese për Koordinatorin Nacional. Përveç këtyre, Sekretariati do të ndihmoj Koordinatorin Nacional për koordinim e strategjisë dhe komunikimin me palët e interesit.

Policia e Kosovës.- Si agjenci e zbatimit e ligjit në kuadër të MPB-së, PK ka përgjegjësinë kryesore në luftimin e terrorizmit, përmes Drejtorisë kundër Terrorizmit dhe strukturave tjera mbështetëse në kuadër të Policisë së Kosovës.

Agjencia e Kosovës për Forenzikë.- Si agjencia për zbatimin e ligjit në kuadër të MPB-së, AKF ka përgjegjësi në kryerjen e ekspertizave forenzike profesionale dhe sipas standardeve ndërkombëtare si dhe në menaxhimin databazave forenzike.

Agjencia e Menaxhimit Emergjent.- Si agjenci në kuadër të MPB-së, AME ka përgjegjësi në zhvillimin e të gjitha masavepër tu përgatitur, mbrojtur, reaguat, dhe rimëkëmbur nga të gjitha rreziqet e mundshme, qofshin ato natyrore apo të shkaktuara nga faktori njeri.

Agjencia e Kosovës për Inteligjencë.- AKI bën identifikimin e kërcënimeve që rrezikojnë sigurinë e Kosovës, integritetin territorial, integritetin e institucioneve, rendit kushtetues, stabilitetin dhe zhvillimit ekonomik, si dhe kërcënimet ndaj sigurisë globale në dëm të Kosovës, duke përfshi nxitjen, ndihmën ose shtytjen dhe përkrahjen e terrorizmit. AKI është agjenci për siguri dhe inteligjencë e cila mbledh, analizon dhe shpërndan produkte inteligjente në mënyrë të shpejtë, të ligjshme dhe të përgjegjshme tek Presidenti, Kryeministri dhe Institucionet tjera kompetente.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës.- KGJK zhvillon politika efektive për sistemin gjyqësor për trajtim më efikas të rasteve të terrorizmit dhe dënimit e personave të përfshirë në aktivitete terroriste. KGJK siguron pavarësinë dhe paanësinë e sitemit gjyqësor në vendim-marrje. Sistemi GjyqësorRastet e terrorizmit në Kosovë trajtohen nga në tri nivele: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Supreme, kurse gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit dhe marrjes së vendimeve

janë të pavarur, të paanshëm, pa ndikuar në qfarëdo mënyre nga asnjë person fizik apo juridik përfshirë edhe organet publike.

Prokuroria e Shtetit.- Është institucion i pavarur, me autoritet dhe me përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të dyshuar dhe akuzuar për përfshirjen e tyre në aktivitete terroriste PSRK ka kompetencë të veçantë që të hetojë dhe ndjek veprat penale të natyrës së vecant, përfshirë edhe kryerjen, përgatitjen, bashkëpunimin dhe lehtësimin e kryerjen së veprave penale të terrorizmit.

Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës.- Sekretariati, si pjesë përbërëse e Këshillit të Sigurisë së Kosovës bën përgatitjen e raporteve periodike dhe analizave për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Këshillin e Sigurisë së Kosovës që kanë të bëjnë me çështjet politike të sigurisë. Duke pasur parasysh rrezikun që aktivitetet terroriste paraqesin për sigurinë e Kosovës, ky sekretariat është poashtu i përfshirë në koordinimin e hartimit të strategjisë nacionale të sigurisë dhe politikave të sigurisë në Kosovë, përfshirë edhe ndërtimin e kapaciteteve, instrumentet e politikave dhe hulumtimit.

Ministria e Drejtësisë.- MD përgatitë dhe zhvillon legjislacionin në fushën e drejtësisë, si dhe koordinon dhe zhvillon bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale. Gjithashtu, bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me të gjitha ministrinë, agjencionet dhe komunitetet fetare të cilat në forma të ndryshme ndërlidhen me procesin e deradikalizimit dhe risocializimit të të dënuarve për terrorizëm

Shërbimi Korrektues.- Shërbimi Korrektues i Kosovës, në bashkëpunim me të gjithë partnerët e drejtësisë synon të korrektojë dhe risocializojë personat e dënuar për aktivitete kriminale me theks të veçant në parandalimin e radikalizimit në burgje duke respektuar të drejtat e tyre fundamentale pa marrë parasysh racën, gjuhën dhe religjionin si dhe siguron një ambient të sigurt për stafin, të burgosurit dhe shoqërinë

Shërbimi Sprovues i Kosovës.- SHSK është përgjegjës për Ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative, mbikëqyrjen, risocializimin, re integrimin dhe rehabilitimin e të gjithë personave që kanë kryer vepra penale të ndëshkueshme sipas ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Po ashtu SHSK, ka për mandat edhe ri integrimin dhe rehabilitimin e personave të liruar me kusht nga burgju.

Dogana e Kosovës.- Si agjenci në kuadër të Ministrisë së Financave, DK duke ushtruar funksionin e vet të kontrollit të mallrave dhe personave në pikat e kalimit kufitar dhe brenda territorit të Kosovës kontribuojnë në parandalimin, identifikimin, raportimin, hetimin dhe bllokimin e burimeve të financimit të aktiviteteve terroriste.

Njësia e Inteligjencës Financiare.- Si agjenci në kuadër të Ministrisë së Financave, NJIF është përgjegjës për kërkimin, marrjen, analizimin dhe shpërndarjen tek autoritet kompetente dhe bërjen publike të informacionit në lidhje me pastrimin potencial të parave dhe financimin e terrorizmit.

Ministria e Punëve të Jashtme.- Ministria e Punëve të Jashtme luan rol të rëndësishëm në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër terrorizmit, duke pasur për mision (përveç tjerave) formulimin dhe zbatimin e politikës së jashtme, zhvillimin dhe bashkërendimin e politikave në raport me vendet tjera si dhe përgjegjësi të rëndësishme të koordinimit të dikastereve qeveritare dhe shtetërore që kanë të bëjnë me çështjet e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Ministria e Integritit Evropian.- MIE siguron që korniza ligjore dhe politikat qeveritare, të lidhura me parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit, janë në harmoni me legjislacionin dhe politikat e BE-së.

Agjencia e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore.- Si organ i pavarur në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, AKMRrSB është agjenci e specializuar për zbatimin e politikave dhe standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi dhe siguria bërthamore.

Zyra për mbrojtjen dhe ndihmë të viktimave.- zyra për mbrojtje dhe ndihmë të viktimave (ZMNV) është zyre e pavarur që funksionin në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit. ZMNV është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve për viktimat gjatë procedurave ligjore, informimin për të drejtat e tyre si dhe përfaqësimin e interesave të tyre në sistemin penal të Kosovës. Zyra po ashtu asiston viktimat në plotësimin e kërkesave për kompensim në procedurat kriminale dhe aplikimin e kompenzimeve shtetërore.

Kosova nuk ka kërcenim direkt terrorist. Ekziston një perceptim jo vetëm në Kosovë dhe rajon se pjesëmarrja e shqiptarëve në luftëra për Shtetin Islamik paraqet një rrezik potencial jo

vetëm për vendet e origjinës nga vijnë këta luftëtarë, por edhe më gjerë. Gjatë vitit 2018 është i njojur rasti “Badovci” i përgaditjes së sulmit terrorist nga disa persona i hetuar nga Policia e Kosovës dhe AKI. Të arrestuarit të Liqeni i Badovcit ishin në fazën fillestare të përgatitjes së sulmit terrorist, Policia e Kosovës ka arrestuar të dyshuarit dhe tani ata janë dënuar nga gjykata dhe janë në vuajtje të dënimit. Po ashtu është i njohur edhe rasti i përgaditjes së sulmit terrorist vetëvrasës kundër ushtarëve të KFOR-it në Kosovë, të dy të dyshuarit u arrestuan pasi Policia kishte përgjuar telefonat e tyre dhe kishte dëgjuar biseda se ata ishin duke përgatitur sulmin.

2.3.5.1. Niveli i pjesmarrësve të shtetasve të Kosovës në luftra terroriste në Siri dhe Irak

Kosova, sikurse vendet tjera në botë, nuk është immune ndaj terrorizmit. Komentet e autoriteteve bëhen një ditë pas publikimit të raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit, i cili vlerëson se Kosova ka bashkëpunuar me SHBA-të në kuadër të luftës kundër terrorizmit. Autoritetet kosovare vlerësojnë se synim i elementeve terroriste mund të jetë shfrytëzimi i Kosovës si vend transit apo logjistik, por jo edhe sulmimi i saj me akte të drejtpërdrejta terrorizmi.

Në vijim do të paraqesim në formë tabelare numrin e pjesmarrësve të shtetasve të Kosovës në organizatat terroriste në Siri dhe Irak

Tabela nr. 1

Vitet	Numri i pjesmarrësve	Niveli arsimor	Gjendja ekonomike	Statusi familjar
2012	208	Fillor dhe i mesëm	Varfur	Të martur
2013	180	Mesëm	Varfur	Të pa martuar/ të martuar
2014	15	Fillor dhe i mesëm	Varfur	Të pa martuar
Gjithsej:	403			

Burimi: Telegrafi 2017

Nga kjo tabelë shihet se numri i pjesmarrësve të kosovarëve në organizatat terroriste në Siri dhe Irak ka qenë jashtëzakonisht i madhë, ku për tri vite këtyre luftrave i`u kanë bashkangjitur 403 kosovarë. Me marrjen e masave nga autoritetet relevante në Kosovë, që nga mesi i vitit 2014 numri i atyre që kanë shkuar në luftrat e huaja ka filluar të bie, e sidomos gjatë vitit 2016, 2017

dhe 2018 numri ka rëndë ndieshëm. Gjatë viteve 2017-2018 nuk ka pasur asnjë rast të shkuarjes në luftrat e huaja nga shtetasit e Kosovës.

3. DEKLARIMI I PROBLEMIT

Le të mendojmë për shembull nevojën për të siguruar një strukturë koordinuese në nivel kombëtar dhe nevojën për të përgatitur një bankë të dhënash kombëtare në lidhje me terrorizmin. Duhet theksuar edhe një herë se del të jetë absolutisht e domosdoshme të përmirësojmë dhe perfeksionojmë instrumentin e bashkëpunimit ndërkombëtar si në nivelin e policisë gjyqësore, duke u nisur nga kushti që, në këtë sektor, ashtu si një gjithë sektorët në lidhje me të ashtuquajturit krime transnacionalë, nuk mund të mos mbajmë parasysh lidhjen me policinë dhe autoritetet gjyqësore të vendeve të ndryshme të përfshira, dhe lipset të sigurojmë – që në fazën e parë të hetimeve paraprake një shkëmbim të shpejtë, të përshtatshëm e konkret të informacioneve dhe akteve, duke kapërcyer mosbesimet dhe vonesat burokratike që sigurisht nuk e lehtësojnë luftën kundër terrorizmin ndërkombëtar.

Analiza e problemeve dhe sfidave bashkëkohore me të cilat përballet Ballkani, çon natyrshëm në përfundimin se, një prej tyre, është edhe fundamentalizmi islamik. Rasti i ndikimit të aktorëve dhe grupeve ekstremiste dhe terroriste në nën-sistemin ballkanik është tejet i rëndësishëm për të materializuar idenë tonë të shpalosur përgjatë kapitujve për disa arsye. Së pari, sepse Ballkani, sikurse dhe pjesa tjetër e Evropës, ka pasur një histori të gjatë raportesh fetare mes komuniteteve të cilat jo-gjithnjë kanë qenë paqësore. Së dyti, nëse historia e hershme ndërthuret me atë të gjysmës së dytë të shekullit të njëzetë, atëherë fillon të sendërtohet një përfytyrim i ndërlikuar raportesh ndër-etnike, ku ndërthuren ideologjia ateiste komuniste e viteve të sistemeve totalitariste, me tranzicionin e stërgjatë të Pasluftës së Ftohtë, me konfliktet e ndryshme etnike që e shoqëruan atë në shumë vende të Ballkanit, si dhe me embrionet e para të liberal-demokracisë, të kurorëzuara për disa vende ballkanike me integrimin gradual në Bashkimin Evropian. Së treti, Ballkani ka funksionuar kaherë si një “ravijëzim ndarës mes dy qytetërimeve” për të huazuar termin e përdorur nga Samuel Huntington, atij të krishterë dhe atij mysliman.

4. METODOLOGJIA

Gjatë përgatitjes së këtij punimi kam përdorur këto metoda:

Metoda e analizës dhe sintezës.- Për të arritur realizimin sa më të plotë të objektivave që synohen të përmbushen në këtë punim, jemi mbështetur në metodën e analizës dhe sintezës, metodë kjo e cila konsiston në formulimin e problemeve ligjore nëpërmjet analizës së normativës që shqyrtohet.

Metodën krahasuese.- Me anë të kësaj metode kanë dalë në pah rrisitë dhe përparësitë e objektit të studimit, si dhe përfundimet e bazuara në argumente bindës, po ashtu, edhe problematika në lidhje me objektin e studimit.

Metodën analitike.- Përmes kësaj metode kam shtjelluar legjislacionin tonë ekzistues dhe legjislacionin ndërkombëtar duke analizuar dhe trajtuar ato elemente që i përgjigjen specifikisht objektit të temës së këtij punimi.

Metoda normative.- Ku me anë të kësaj metode kam hulumtuar anën formale të normave dhe akteve juridike, duke u bazuar kryesisht në fuqinë e tyre juridike, duke studiuar përbërjen e ligjeve dhe rregulloreve si dhe lidhjet dhe raportet ndërmjet tyre.

Metodën e kërkimit doktrinar.- Nëpërmjet kësaj metode është arritur të bëhet identifikimi, mbledhja dhe sistemimi i librave, monografive, studime shkencore të autorëve dhe bashkautorëve specialistë të fushës të së drejtës penale dhe kriminalistikës.

Metodën interpretuese.- Përmes kësaj metode është realizuar gërshetimi i metodave të mësipërme, duke arritur në konkluzione mbi atë se çfarë mund të përmirësohet nga pikëpamja legjislative, por edhe zbatimi në praktikë të legjislacionit ekzistues.

5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Është vërtet i padiskutueshëm fakti që “terrorizmi” është para së gjithash një koncept politik dhe metajuridik, e për këtë arsye ndikohet nga faktorë historikë, politikë, kulturorë, ideologjikë. Nga kjo rrjedh sidomos vështirësia për të formuluar një përkufizim universal të vlefshëm, meqë një veprim i dhunshëm që një legjislacion (i mbështetur në një sistem të dhënë ideologjik) mund ta cilësojë si terrorist, për një tjetër legjislacion mund të konsiderohet madje si një veprim themelues i një marrëveshjeje të re kushtetuese. Pikërisht këto përsiatje e kanë shtyrë një pjesë të mirë të historiografisë filozofike ta konsiderojë këtë nocion të përnjimend të vetëm për shoqëritë demokratike perëndimore, duke shmangur, nga ana tjetër, përdorimin e këtij lloji cilësimi kur forma të dhunshme të opozitës politike shfaqen në sistemet jo demokratike.

Shtytja drejt një frike kolektive që qëndron me kufijve të pasigurisë individuale, vënia në diskutim e aftësive të aparateve institucionale për të shmangur rreziqet për integritetin social dhe denoncimet e zhurmshme të mjeteve të komunikimit (në të cilat përzihen tërheqja dhe paniku në një lloj reaksioni zinxhir duke lënë hapësirë për të përfytyruar përjasje të mundshme ndaj aftësisë dhe forcës së tyre për t’u organizuar) duke përfaqësuar pikërisht manifestin objektiv të veprimit të këtyre grupeve terroriste. Qëllimi i mirëfilltë që kërkojnë të arrijnë është ngjallja e një gjendjeje paniku, frike kolektive, duke krijuar njëkohësisht një mosbesim të thellë ndaj aftësive të organeve institucionale për të garantuar paprekshmërinë e jetës publike. Sigurisht që nuk mungojnë përkufizime të shumta të termit terrorizëm në literaturën penale, e cila ka nënvizuar një dimension të dyfishtë, objektiv dhe subjektiv, të këtij fenomeni.

Dimensioni i parë ka të bëjë me ngjyrimet e veçanta të aktit terrorist, që lidhen për më shumë me “cilësinë e personit të dëmtuar, që përfaqëson në njëfarë mënyre institucionet, apo mundësinë e personit të dëmtuar që është në gjendje t’u drejtohet personave të pacaktuar, pra për të ngjallur frikë në komunitet; fakti që viktimat nuk kanë lidhje individuale me terroristin, pasi viktimat zgjidhen jo për marrëdhëniet e tyre individuale me atë që vepron, por për marrëdhëniet e tyre me institucionet ose thjesht për arsye se janë anëtarë të shoqërisë”. Dimensioni i dytë, me karakter subjektiv, përqendrohet në nevojën që akti terrorist të kryhet për një qëllim politik, i cili mbështetet nga një kundërshtysë e fortë ideologjike. Është vërejtur në veçanti se “ajo që dallon terrorizmin modern nga forma të tjera dhunë politike është karakteri i tij.

Demokracia civile është themeluar ndërmjet vlerave universale të dinjitetit njerëzor, lirisë, barazisë dhe solidaritetit dhe parimeve të shtetit të së drejtës. Terrorizmi përbën një prej dhunimeve më serioze të këtyre parimeve. Terrorizmi përbën një kërcënim për demokracinë, për ushtrimin e lirë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe zhvillimit social e ekonomik. Si Bashkimi Europian, por edhe Kombet e Bashkuara kanë miratuar një sërë konventash dhe aktesh të tjera ndërkombëtare për të luftuar terrorizmin. Duke pasur parasysh këto, rekomandojmë, se:

- duhet të arrihet një përkufizim i përafërt mbi veprat terroriste në planin ndërkombëtar, duke përfshirë edhe veprimtarinë e grupeve terroriste. Për më tepër duhet të sigurohen sanksione penale si për personat fizikë edhe për personat juridikë, të cilët kanë kryer ose mbajnë përgjegjësi për vepra të tilla penale;
- duhet të vendosen rregulla të juridiksionit që të sigurojnë se vepra të tilla terroriste do të ndiqen penalisht në mënyrë efektive;
- duhet të merren masa të veçanta, të nevojshme për mbrojtjen e viktimave të terrorizmit;
- duhet të sigurohen dhe respektohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, ashtu siç përcaktohen në akte të ndryshme ndërkombëtare për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut;
- gjatë konflikteve të armatosura, shtetet duhet të ndërmarrin aksione të përdorimit të forcave të armatosura, në përputhje me aktet humanitare ndërkombëtare.

Gjendja aktuale e terrorizmit në ditët e sotme paraqitet kryesisht në formën e terrorizmit ndërkombëtar. Kjo formë matrice e marrëdhënieve midis grupeve të ndryshme terroriste është ajo që e bën terrorizmin ndërkombëtar kaq të rrezikshëm. Bashkëpunimi në luftën kundër terrorizmit është jo vetëm një çështje e zbatimit të ligjit, por kërkon gjithëpërfshirje të shumë institucioneve dhe shtrirje në planin ndërkombëtar.

6. REFERENCAT

1. Alex P . Schmid, Political Terrorism: A Research Guide to Concepts, Theories, Data Bases and Literature, Amsterdam 1983.
2. Brian M. Jenkins, International Terrorism: A Blance Sheet, The International Institute for Strategic Studies, London, Juli/August 1975; Franz Wörderman, Terrorismus, Motive, Täter, Strategien, München 1977.
3. Brian Jenkins, “*The Study of Terrorism: Definitional Problems*”, RAND Corporation, Dhjetor 1980.
4. Bruce Hoffman, “Terrorism and ĘMD: Some Preliminary Hypotheses”, në “*Non-Proliferation Revieė*”, Vėll. 4, Nr. 3, Pranverė-Verė 1997.
5. Combating Terrorism, Strategies of ten countries, University of Michigan, 2002.
6. European Union Global Strategy, A Global Strategy for the European Union’s Foreign And Security Policy, 2016.
7. Georgios Kaouras, Terrorismus, historische und politische Komponenten des terroristischen Phänomens, Europäische Hochschulschriften, Peter Lang, Frankfurt am Main 1993.
8. Haki Demolli, Terrorizmi, Prishtinë, 2002.
9. Human Rights in Counterterrorism Investigations: A Practical Manual for Law Enforcement Officers [Tė Drejtat e njeriut në hetimet kundėr terrorizmit: Manual praktik pėr punonjėsit e organeve tė rendit], (Varshavė: OSBE/ODIHR, 2013),.
10. International Terrorism” [Deklarata pėr masat nė lidhje me eliminimin e terrorizmit ndėrkombėtar], Dokumenti A/RES/49/60, 1994, para. 1; dhe rezolutat e Kėshillit tė Sigurimit tė OKB-sė 1373 (2001), para. 3, dhe 1566 (2004).
11. International and Regional Legal Instruments Related to Terrorism and Cooperation in Criminal Matters” [Statusi nė zonėn e OSBE-sė i konventave dhe protokollove universale antiterrorizėm, si edhe instrumenteve tė tjera ndėrkombėtare dhe rajonale qė lidhen me terrorizmin dhe bashkėpunimin nė çeshtjet penale], OSBE, shtator 2013.
12. I. Xhanan, A. Gynesh, A. Oksyz, H. Jyxheoglu; Njė vėshtrim Islam mbi terrorin dhe sulmet vetėvrasėse, Tiranė, 2006.
13. Jonathan R. White, 2004., Terrorism (pėrkthim nga anglishtja, Beograd, 2004.

14. Jamie Shea, “NATO and Terrorism”, në “*RUSI Journal*” (Royal United Services Institute for Defence and Security Studies), Vëll. 174, Nr. 2, Prill 2002.
15. Kolë Krasniqi, Terrorizmi ndërkombëtar, Prishtinë, 2010.
16. Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin e Terrorizmit, Varshavë, 2005
17. Konventa Ndërkombëtare kundër Marrjes së Pengjeve (18 dhjetor 1979 në Nju Jork) (dhjetor 18, 1979 në Nju-Jork).
18. Këshilli i Evropës, Rekomandimi (2005)10 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi “Teknikat speciale të hetimit” në lidhje me krimet e rënda, duke përfshirë aktet e terrorizmit, Strasburg, 20 prill 2005.
19. International Terrorism” [Deklarata për masat në lidhje me eliminimin e terrorizmit ndërkombëtar], Dokumenti A/RES/49/60, 1994; dhe rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1373 (2001), dhe 1566 (2004).
20. Konventa Ndërkombëtare kundër Marrjes së Pengjeve (18 dhjetor 1979 në Nju Jork) (dhjetor 18, 1979 në Nju-Jork).
21. Karta e OKB-së.
22. Deklaratën Universale.
23. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.
24. Konventës së Vjenëse vitit 1988.
25. Ligji nr. 03/l-196 “Për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit”.
26. Maksimillien Robespierre, “Justification of the use of Terror”, libri i Historisë Moderne.
27. Mirjam Dittrich, “Një reagim europian mbi terrorizmin global”, Janar 2005.
28. Paul R. Pillar “Terrorism and U.S Foreign Policy”, Brookings Institute Press: Washington DC, 2001.
29. Rezoluta nr. 1566 (2004) miratuar nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së, në takimin e vet nr. 5053, më 8 tetor 2004 (S/RES/1566 (2004)).
30. Smith W. H., International Terrorism. A Political Analysis. Në librin : The Year Book of World Affairs. Vol. 31. 1977.
31. Strategjia Shtetërore kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022, Prishtinë, 2017.
32. Shaban Sulejmani, Dukuria e terrorizmit,-studim krahasues juridik penal, Shkup, 2014.

33. Shkelzen Marevci, Luftimi i terrorizmit bashkëkohor, Ferizaj, 2014.
34. Tim Pat Coogan, The IRA, Palgrave, New York, 2002.
35. Vesel Latifi, Ismet Elezi, Vasilika Hysi, Politika e luftimit të kriminalitetit, Prishtinë, 2012.
36. Vesel Latifi, Mediat dhe terrorizmi, Revista Juridica, Prishtinë, 2010.
37. Vesel Latifi, Kriminalistika- Zbulimi dhe të provuarit e krimit, Prishtinë, 2011.
38. Walter Laqueur, Terrorismus, Die globale Herausforderung, Ullstein 1987.
39. Willikson Paul. Political Terrorism. London - Basingstoke: Macmillan Press. 1974.
40. Direktiva 2001/97/EC e Bashkimit European.
41. <https://telegrafi.com/historia-e-terrorizmit-hovi-keq-shekulli-xix-dhe-shekullit-xx/>